

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

16.01.2023
Ora 12:35

RENDI I DITËS

**Për shqyrtimin e kërkesës nr. 04, datë 14.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të
zgjedhjeve**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Z. Erdal Mema, Znj. Blerta
Ereqi, Z. Kristi Puleri
- **Parti Politike** PR, PSD, PLL, PBKD, LZHK, PBPPSH
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. K. Bele: Përshëndetje të gjithëve, deklaroj të çelur seancën e sotme për shqyrtimin e vendimit nr. 224, dt.7.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me objekt miratimin e raportit të zgjedhjeve ndaj auditimit të fondeve publike të përftuar dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të dt. 25.04.2021. Sipas shortit të hedhur relatori i kësaj seance jam unë Koli Bele. Ndaj këtij që Komisioneri e ka konsideruar vendim, janë paraqitur disa materiale me natyrë ankimore nga subjekti, gjithësesi ne do shprehemi gjatë rrugës për mënyrën se si do të veprojmë në lidhje me këto materiale. Para se të fillojmë shqyrtimin e çështjes verifikojmë prezencën dhe legjitimitimin procedural të palëve, të cilat kanë ardhur në këtë seancë. Besoj janë të pranishme subjektet të cilat kanë paraqitur kërkesa apo ankime dhe nuk e di.., shumë shkurt, ju lutem cilat janë subjektet për efekt të evidentimit dhe cilat janë palët që kemi në proces. Ndoshta me rradhë po e fillojmë nga zotëria më i moshuar, që të kemi një prezantim.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. S. Jenisheri, përfaqësues i PBPPSH: Kryetari i Partisë Pensionistëve të Shqipërisë.

Z. K. Bele: Po faleminderit.

Z. A. Alimadhi, përfaqësues i PBKD: Partia Balli Kombëtar Demokrat.

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Partia Republikane.

Z. F. Haberiku, përfaqësues i PLL: Partia Lëvizja e Legalitetit:

Z. F. Topollaj, përfaqësues i BD: Bindja Demokratike:

Z. R. Preçi, përfaqësues i PSD: Partia Socialdemokrate:

Z. R. Vrenoz, përfaqësues i LZHK: Lëvizja për Zhvillimin Kombëtar:

Z. A. Feto, përfaqësues i FRD: Jam dhe unë i Frymës së Re Demokratike.

Z. K. Bele: Po faleminderit, të pranishëm janë sekretari i Përgjithshëm dhe administrata e KQZ-së. Ju bëjmë pyetje palëve që janë prezente nëse kanë ndonjë kërkesë paraprake lidhur me shortin apo me anëtarët e KAS-it, mungesë kompetence, përjashtim anëtarësh, apo konflikt interesi. Nëse s'kemi kërkesa të tjera, konstatojmë që në këtë fazë krahas atyre subjekteve të cilat kanë paraqitur materiale ankimore në fazën e parë dhe që janë trajtuar në mbledhjen tonë të parë, të verifikimit paraprak, kur kemi vendosur ta kalojmë për shqyrtim. Konstatohet që

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

pranë administratës së KQZ-së kanë paraqitur ankesë subjektet: Partia Nisma Thurje, Partia Fryma e Re Demokratike dhe Partia Lëvizja e Legalitetit, që do të bëhen pjesë e shqyrtimit të sotëm. Nuk dëgjova që Partia Nisma Thurje është prezente? Dakord, pavarësisht kësaj, ashtu siç jemi shprehur në seancën e parë paraprake. KAS i konsideron këto kërkitime si kërkitime të cilat vijnë drejtë për drejtë dhe bëhen pjesë e shqyrtimit. Duke qenë se ne po gjykojmë, po vlerësojmë vendimmarrjen ose raportin e Komisionerit, gjetjen dhe vendimmarrjen e administratës së KQZ-së për këtë fazë të procesit, këto ankime bëhen automatikisht pjesë e kesaj seance dhe do të trajtohen bashkë me ankime të tjera të paraqitura nga subjektet. Nëse nuk kemi ndonjë kërkesë paraprake në këtë fazë të procesit vazhdojmë me shqyrtimin e çështjes në themel. Ftojme sekretarin e Përgjithshëm të bëjë një paraqitje të shkurtër të çështjes, kryesisht të problematikave ligjore të saj. Po Ylli.

Z. Y. Merkaç: Atëhere, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 224 dt. 7.12.2022 ka miratuar raportin e gjetjeve nga auditimi i fondeve publike të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Në përfundim të shqyrtimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka konstatuar shkelje si më poshtë:

- për Partinë Demokratike, nuk i është përgjigjur kërkesës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Gjithashtu Partia Demokratike nuk ka dorëzuar raportet e 69 kandidatëve nga listat shumemërore si dhe raportet e dorëzuara nga subjekti zgjedhor janë bërë me korrigjime në shkrim;
- për Partinë Demokristiane, rezulton se shpenzimet për aktivitetin e fushatës në vlerën e 61.000 lekë nuk janë shoqëruar me dokumenta justifikuese;


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

- për Partinë Lëvizja për Zhvillimi Kombëtar, ka kryer shpenzime për fushatë pa dokument justifikues në shumën 325.000 lekë, nga të cilat 150.000 lekë nuk janë paguar akoma. Gjithashtu nuk kanë dorëzuar raportin për një kandidat nga lista shumemërore e kësaj partie;
- kandidati i Partisë Lëvizja e Re, Fatmir Lala rezulton se ka pranuar dhurime në para në dorë më shumë se 50.000 lekë. Përkatësisht një dhurim në shumën 141.000 lekë;
- për Partinë Lëvizja e Legalitetit, rezulton se nuk ka dorëzuar raportet për tre kandidatë nga lista shumemërore;
- gjithashtu për Partinë Socialiste nuk kanë dorëzuar raporte 17 kandidatë nga lista shumemërore, si dhe raportet e dorëzuara nga subjekti janë me korigjime me shkrim duke mos respektuar kështu vendimin nr. 13 datë 6 Prill 2021 të Komisionit Rregullator. Partia Socialiste ka tejkalar kufirin maksimal të shpenzimeve të fushatës zgjedhore;
- për Partinë Republikane nuk ka dorëzuar raportet për tre kandidatët nga lista shumemërore duke mos respektuar vendimin nr. 13 të Komisionit Rregullator;
- për Partinë Balli Kombëtar, nuk ka respektuar vendimin nr. 13 të datës 6 Prill të Komisionit Rregullator, duke mos dorëzuar raportin financiar të fushatës sipas formatit të standardizuar;
- për Partinë Bashkimi Popullor i Pensionistëve të Shqipërisë nuk ka respektuar vendimin nr. 13, duke mos dorëzuar raportin sipas formatit të standardizuar;
- e njëjta gjë edhe për Partinë politike Nisma Thurrje, nuk ka dorëzuar raporte për 152 kandidatë nga lista shumemërore;
- gjithashtu edhe Partia Bindja Demokratike, nuk ka dorëzuar raportet për 153 kandidatët nga lista shumemërore;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

- Partia Lëvizja Demokratike Shqipëtare, nuk ka dorëzuar raportet për 153 kandidatë nga lista shumemërore duke mos respektuar kështu vendimin nr. 13 datë 6 prill 2021 të Komisionit Rregullator;
- Partia Socialdemokrate nuk ka dorëzuar raportet për 153 kandidatë të listave shumemërore;
- dhe Partia Balli Kombëtar nuk ka dorëzuar raportin financiar të fushatës si dhe nuk janë dorëzuar raportet për 153 kandidatë nga lista shumemërore.

Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar nenit 19 shkronja “c” të ligjit të Kodit Zgjedhor dhe neni 173 pika 1, 2, 3, 5, 8, 9 të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit dhe nenit nr. 35 të Rregullores KAS-it, i ka propozuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, propozimin për masë të gjitha këto parti duke vendosur dhe masat përkatëse nga 50.000 dhe 100.000 sipas shkeljeve respektive. Në këto kushte disa nga partitë politike duke mos qenë dakord me vendimin e Komisionerit kanë paraqitur ankim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Ndër to pesë partitë, ku dy partitë e para, Partia Demokristiane Shqipërisë dhe Republikane është hedhur shorti në javët e kaluara. Ndërsa përsa i përket Frymës Demokratike dhe Partia Lëvizja e Legalitetit nuk është hedhur ende shorti por është lënë që do të bashkohen me çështjet e tjera.

Z. K. Bele: Ne do t'i trajtojmë të gjitha një për një, besoj do të ketë dhe pyetje. Kisha vetëm një... më shumë për një kuptueshmëri nga ana ime. Në mos gaboj për një nga partitë, Partia e Pensionistëve ju thatë nuk është raportuar sipas standardit, pra ka raportim por nuk është sipas formatit të standardizuar të KQZ-së? Nëse ju kujtohet në këtë fazë? Nëse s'ju kujtohet do t'ju dëgjoj të gjithëve mos kini merak.

Z. A. Alimadhi, përfaqësues i PBKD: Jo..., po për procedurë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. K. Bele: Po të lutem!

Z. A. Alimadhi, përfaqësues i PBKD: Në fakt këtu u përmënd sigla e subjektit tim Partia Balli Kombëtar dy herë, është i njejt argument ose fjali siç thatë ju, edhe për formatin që nuk është dorëzuar, edhe për dorëzimin e formularëve të 153 kandidatëve është dy herë sigla, nëse mundet është sigla jonë apo..?

Z. K. Bele: Për efekt të, që ne duke qenë që kjo është një shqyrtim ose është një çështje që ka më shumë se numri i zakonshëm i palëve në një proces, për të qenë korrekt dhe me procedurën, por dhe me adresimin e të gjithave atyre që ju keni për të parashtruar. Ne do t`ju marrim të gjitha subjektet njëri pas tjetrit në mënyrë që dhe rekordet dhe kur ne të analizojmë provat të na mundësojnë shqyrtimin sa më të plotë. Kështu që për secilin mbas kësaj, mbas parashtrimin të sekretarit të Përgjithshëm, e nëse kolegët nuk kanë në këtë fazë ndërhyrje unë do t`ju. Po...

Z. A. Alimadhi, përfaqësues i PBKD: Pra, unë kam një kërkesë për ta kuptuar qartësisht. Është lexuar dy herë subjekti im Partia e Ballit Kombëtar.

Z. K. Bele: Dakord!

Z. A. Alimadhi, përfaqësues i PBKD: A është Partia e Ballit Kombëtar dy herë e penalizuar? Pra, për formatin që ngriti sekretari i Përgjithshëm, apo mos dorëzimi i 153 formularëve të kandidatëve?

Z. K. Bele: Ylli mund ti përgjigjesh?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. Y. Merkaj: Atëhere, bëhet fjale për dy parti, është Partia Balli Kombëtar Demokrat i cili nuk ka dorëzuar raportin financiar, dhe Partia Balli Kombëtar nuk ka paraqitur raportin e 152 kandidatëve të listave.

Z. K. Bele: Pra, kemi dy parti?

Z. Y. Merkaj: Dy parti të ndryshme, dy subjekte të ndryshme.

Z. K. Bele: Mirë faleminderit, Besoj e ezauroi.


Z. A. Alimadhi, përfaqësues i PBKD: Po, pra ne jemi te 153 kandidatët?

Z. Y. Merkaj: 152.

Z. A. Alimadhi, përfaqësues i PBKD: Dakord.

Z. K. Bele: Mirë, pra për ta bërë të qartë edhe njëherë. Unë e përmenda pak më parë, edhe materialet ankimore që janë sjellë në këtë fazë nga subjektet, nga tre subjektet e tjera. Nisma Thurja, Partia Fryma Demokratike dhe Partia Lëvizja e Legalitetit do të konsiderohen si pjesë e të njëjtës çështje dhe qëndrimet dhe prapësimet e çfarëdo pretendimi që ata do të ngrenë në seancë, do të trajtohen në të njëjtën rrugë si dhe të tjerat. Tani, ne do të ftojme subjektet për të bërë secila prapësimet e veta dhe nuk e di për procedurë Ylli je dakord të vazhdojmë siç janë renditur, apo do të marrim listën e parashtruar nga ana juaj për efekt të raportit? Se nuk di se çfarë materiali kanë përpara palët.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Më fal kryetar, për procedurë sipas rradhës që janë bërë ankimimet se kanë një kohë.

Z. K. Bele: Është e saktë, prandaj kërkova nga ju që e keni ndjekur atë rast.


Z. Y. Merhaj: Kërkesa ankimore e para është kërkesa nr.10 Partia Demokristiane e Shqipërisë.

Z. E. Çefa: Mund të sqaroj diçka?

Z. K. Bele: Po të lutem.

Z. E. Çefa: Atëhere ndjesë se nuk dua të ndalojmë shumë në këtë fazë. Për subjektet politike ka patur një keqkuptim në paraqitjen e kërkesave ankimore nga ana juaj, sepse kjo nuk është çështje ankimore. Themeli i kësaj çështje po gjykohet sot. Pra, nuk po shqyrtojmë ankim, po shqyrtojmë vendimin e Komisionerit Shtetëror i cili i propozon KAS-it marrjen e këtyre masave administrative ndaj subjekteve politike. Kështu që të mos krijojmë konfuzion ndërmjet kërkesave ankimore dhe kërkesave të Komisionerit, ne duhet t'i referohemi kërkesës së Komisionerit sot. Ankimimet tuaja, proceduralisht janë bashkuar në trajtimin e kësaj çështje, pak rëndësi ka nëse janë quajtur ankime dhe kjo nuk na prish punë. Thelbi i çështjes sot është të diskutojmë propozimet e Komisionerit, dhe ju keni të drejtë të jepni shpjegimet tuaja kundër, apo argumentat kundër këtyre propozimeve. Vendimi final për gjobitjen do të merret sot nga ky komision, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*


Z. K. Bele: Besoj jemi të qartë në këtë fazë, sepse duhet të kuptojmë që këto janë procedura të cilat bëhen për herë të parë në këtë format që ka KQZ-ja. Ne mundohemi që të jemi sa më korrekt proceduralisht dhe ta bëjmë procesin sa më të kuptueshëm për të garantuar aksesin e palëve dhe mbrojtjen e drejtë nga ana tyre. Po të lutem, vetëm mos ta bëjmë..., sepse do ngelemi në diskutim.

Z. A. Alimadhi, përfaqësues i PBKD: Jo një sekondë. Tani këto subjektet që i kanë paraqitur, se në fakt ne nuk ishim të njohur me atë që shpjegoi zoti Çefa. Ne subjektet që nuk kemi bërë ankimimin përzihemi futemi të gjithë bashkarisht?

Z. K. Bele: Që mos të humbasim mbas termit ankim/vendim, ajo që KAS konstaton në frymën dhe në germën e ligjit, ky vendim merret sot. Komisioneri ka sjellë një material, mund të quhet vendim për kërkesë, mund të quhet kërkesë, kjo ka pak rëndësi sepse është term procedural. E rëndësishme është që të kuptohet që ato gjetjet e Komisionerit dhe propozimi i tij do të shqyrtohet në këtë seancë edhe kërkimet që palët kanë dhe prapësimet dhe çfarë do të argumenti që ju keni në mbështetje të argumentit tuaj si subjekte do të trajtohet në këtë seancë. KAS do të disponojë në fund me një vendim i cili do t'i analizojë të gjitha këto për secilin subjekt veç e veç.

Z. S. Jenisheri, përfaqësues i PBPPSH: Unë përfaqësoj Partinë Bashkimi Popullor i Pensionistëve të Shqipërisë e jam kryetari i saj. Dua të di që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve a është në dijeni që partia jonë ka qenë pjesë e Koalicionit të ABEOK bashkë me Partinë Ora e Shqipërisë, Konservatorët dhe Emigrantët? Sepse ne na përfaqëson..., koalicionin tonë, këto katër parti, na përfaqëson Partia e Konservatorëve me zotin Kujtim Gjuzi. Nuk dihet nëse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka në konsideratë këtë, meqenëse partitë e tjera të koalicionit tonë..., a

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

më kupton nuk janë penalizuar? Çfarë të them, nuk përfshihen në atë vendim që ka dhënë Komisioneri. Më duket se nuk është e drejtë që unë të jem thirrur për këtë gjë. Ne kemi përfaqësuesin e ABEOK-ut, kemi përfaqësuese Partinë Konsevatore me kryetarin Kujtim Gjuzi. Megjithatë unë jam i gatshëm t`ju them arsyet e mia me të cilat pse nuk jam dakord me atë vendim që ka marrë Komisioneri, faleminderit.

Z. K. Bele: Faleminderit, subjekti juaj elektoral si dhe koalicioni në fjalë që ju përmendet ka qenë pjesë dhe në zgjedhje dhe është bërë palë në disa kërkesa ankimore. Kështu që KQZ-ja ka patjetër në konsideratë rregullimin ligjor dhe mënyrën se si ju keni zgjedhur të bëheni pjesë e garës dhe do ta ketë në konsideratë trajtimin e rastit tuaj. Tani që të vazhdojmë dhe për ekonomi të procesit, ne po i marrim dhe njëherë ju lutem, ti marim edhe një herë me rradhë secilën nga palët. Atëherë po i marrim sipas subjekteve të listuara dhe ne do të marrim pretendimet e secilës palë.

Ju lutem për Partinë Demokratike? Dakord, s`kemi palë prezent.

Vazhdojmë me Partia Demokristiane të Shqipërisë, gjithashtu nuk është prezent. Partia Lëvizja për Zhvillimin Kombëtar, po të lutem!

Z. R. Vrenoz, përfaqësues i LZHK: Po faleminderit për fjalën! Ne pasi jemi njohur me propozimin për vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kanë qenë tre pika që penalizonin subjektin zgjedhor Lëvizja për Zhvillimin Kombëtar. Një prej tyre e kemi konstatuar të drejtë në raport me kthimin e një shume prej 50.000 lekësh të rejash të cilat kemi tërhequr faturën pranë financës të KQZ dhe e kemi shlyer, ndërkohë për masën e gjobës prej 500.000 për subjektin dhe 100.000 për financieren e subjektit e cila nuk ka qenë në Shqipëri në atë kohë, për efekt Covidi po jetonin në Itali, pra nuk kemi pas një financiere, pra na duket e tepërt. Duke parë dhe shumën

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*


e akorduar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nga Buxheti i Shtetit në masën 1.380.000 lekësh në favor të Lëvizjes për Zhvillim Kombëtar si fond për periudhën zgjedhore. Kjo shuma prej 60.000 lekësh koorespondon afërsisht me një të dytën dhe na duket shumë, shumë e lartë dhe do kërkonim që të ulej kjo vlera e gjobitjes nëqoftëse ju vlerësoni që do të qëndrojë propozimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në të kundërt do të kërkonim që të zeroheshin këto gjoba, faleminderit.

Z. K. Bele: Po faleminderit. Kemi ndonjë pyetje në këtë fazë? Dakord vazhdojmë, Lëvizja e Re, kandidati partisë politike Lëvizja e Re Fitimtar Lala? Jo! Partia Lëvizja e Legalitetit?

Z. F. Haberiku, përfaqësues i PLL: Përsa i përket vendimit të Komisionerit, ne do të japim këtë opsion, vendimi i komisionerit është për miratimin e raportit të gjetjeve mbi auditimin e fondeve publike. Partia Lëvizja e Legalitetit nuk ka pasur fonde publike në atë kohë, ka qenë në koalicion me Partinë Demokratike dhe bazuar në nenin 65, pika 3 në të cilit thuhet që “në momentin e regjistrimit koalicioni duhet të deklarojë partinë udhëheqëse”. Partia udhëheqëse ishte Partia Demokratike dhe ne e lamë që Partia Demokratike do të bënte raportin, pasi ne si parti nuk kishim asnjë të ardhur edhe në përgjigjen që i është kthyer Komisionerit kur kërkoi nga Partia Lëvizja e Legalitetit ne i deklaruar 70 dollarë ishin bërë shpenzime nga buxheti personal i kandidatit. Tani duke qenë se e shohim që ne nuk kemi pas të ardhura të mëdha dhe duke qenë se ishim në një koalicion me një parti që ishte ajo udhëheqëse e koalicionit, mendonim që do t’i bënin ata këto veprime.

Z. K. Bele: Më fal, mendonim në fund, se nuk e dëgjova të lutem?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. F. Haberiku, përfaqësues i PLL: Ne mendonim se do t'i bënte partia që ishte partia udhëheqëse e koalicionit. Pasi partia jonë nuk kishte asnjë të ardhur dhe vendimi i Komisionerit është për të ardhurat nga fondet publike, por ne s'kemi pas të ardhura, kështu që mendojmë që gjoha, kur ne nuk kishim asnjë të ardhur dhe ato 70 dollarë që i kemi thënë, i kemi vlerësuar tamam aq për ato. Mendojmë që nuk qëndron ky fakt për partinë tonë.

Z. K. Bele: Dakord faleminderit. Kemi pyetje? Po të lutem!

Z. E. Çefa: Doja të dija thjesht nëse ashtu sikundër kodi dhe vendimi nr. 13 e detyron, partia juaj ka një financier të emëruar dhe të deklaruar në KQZ i cili është i ngarkuar që të merret me të gjitha këto deklarime për shpenzime?

Z. F. Haberiku, përfaqësues i PLL: Mbas zgjedhjeve me thënë të drejtën, sepse ngaqë ne s'kemi pas asnjë të ardhur nga fondet publike, nuk e di para zgjedhjeve kush ka qenë, por pas zgjedhjeve jam caktuar unë.


Z. E. Çefa: Ju jeni financieri?

Z. F. Haberiku, përfaqësues i PLL: Po mbas zgjedhjeve.

Z. E. Çefa: Dakord, faleminderit.

Z. K. Bele: Për subjektin tjetër Partia Socialiste e Shqipërisë? Nuk është prezente. Partia Republikane e Shqiptare?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Atëherë subjekti zgjedhor Partia Republikane i është drejtuar me kërkesë ankimore të saj, Komisionit Ankimimeve dhe Saksioneve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me objekt ankim kundërshtimin e vendimit 224 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e raportit të gjetjeve etj...”. Nëpërmjet këtij vendimi Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka propozuar KAS-it marrjen e masës administrative për Partinë Republikane me gjobë në vlerën 500.000 lekë sipas nenit 173 pika 3 të Kodit Zgjedhor për shkakun e deklaruar se: Partia Republikane nuk ka dorëzuar raport për një kandidat të saj të listës shumëmemërore. Duke mos respektuar vendimin nr. 13 datë 6 Prill 2021 të Komisionit Rregullator dhe për këtë arsye nuk është audituar raporti i kandidatit Ludovik Hasani, kandidat i listës shumëmemërore të subjektit Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim për Qarkun Shkodër. Partia Republikane brenda afatit ligjor parashikuar në Kodin Zgjedhor i është drejtuar KAS-it duke kërkuar prej tij, mos pranimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të shprehur në pikën 8 të vendimit të Komisionerit nr. 224 datë 7.12.2022. Në mënyrë të përmbledhur në kërkesën e saj ankimore Partia Republikane ka parashtruar faktet, rrethanat, argumentet dhe provat me të cilat mbështeten pretendimet e saj si më poshtë:

1- Në tekstin e propozimit për gjobitje të Komisionerit Shtetëror nuk rezulton e analizuar dhe e shprehur specifikisht shkelja konkrete e pretenduar si e kryer nga Partia Republikane, në referim të vendimit nr. 13 dt. 6 prill të Komisionit Rregullator.

2 - Partia Republikane mori pjesë në zgjedhjet e 25 prillit si pjestare e Koalicionit Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim. Në referim të nenit 65 pika 3 Kodit Zgjedhor për efekt të përmbushjes nga ana e saj dhe detyrimit të parashikuar nga Kodi Zgjedhor, për raportimin e të ardhurave shpenzimet e fushatës zgjedhore, Partia Republikane në procesin e një procedimi administrativ duhet konsideruar

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

rrethana se për partitë pjestare të koalicionit të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përcakton Kodi Zgjedhor përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit.

3 - Gjeditja e Partisë Republikane pa shkaqe të arsyeshme të pa mbështetura në ligj dhe të pa argumentuara dhe në rrethanat kur kandidati i saj Ludovik Hasani me dashje nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për deklarimin e të ardhurave dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore, do të krijonte ndër të tjera premisa për pasoja tepër të rënda deri në asgjësimin e mekanizmit të garantimit për përmbushjen e vetëdeklarimit kandidatët siç është shprehur në mënyrë taksative neni 90 pika 4 e Kodit Zgjedhor, si dhe pika 3 e nenit 9 të vendimit Komisionit Rregullator nr. 13, datë 6 Prill 2021.

4 - Në referim të nenit 90 pika 4 e Kodit Zgjedhor subjekti zgjedhor, theksoj “subjekti zgjedhor” mban përgjegjësi për shkeljen e kushteve dhe detyrimeve lidhur me financimin nga ana e kandidatëve të saj, me përjashtim të rastit kur nga hetimi administrativ vërtetohet se subjekti zgjedhor nuk ka pasur mundësi ose me gjithë përpjekjet e bëra nuk ka arritur të parandalojë, ose të korigjojë shkeljen e kryer nga kandidati. Në këtë rast përgjegjësia administrative dhe penalitetet për shkeljen i ngarkohen kandidatit. Kështu shprehet neni 90, pika 4. Gjithashtu në pikën nr. 2, të vendimit 13, dt. 6 prill 2021 përcaktohet se “kandidatët kanë detyrimim të dorëzojnë te financieri brenda 30 ditëve nga data e zgjedhjeve dokumentacionin për fondet e përfituara dhe shpenzuara prej tyre gjatë fushatës zgjedhore”. Në vështrim të komunikimit për njoftimin e kandidatit Ludovik Hasani nga Partia Republikane, rezulton e provuar se nëpërmjet njoftimit elektronik të datës 29 qershor 2021 kandidatit Ludovik Hasani i është përcjellë baza ligjore, materiali informues dhe gatishmëria e Partisë Republikane për të asistuar me ndihmën e saj kandidatit, si mbartës i detyrimit për deklarimin e tij nëpërmjet formularëve përkatës për financimin dhe shpenzimin e fushatës zgjedhore. Pas konfirmimit për marrjen në

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

dijeni të këtij njoftimi, kandidati Ludovik Hasani nuk paraqiti asnjë rezervë dhe ndërkohë nuk përmbushi detyrimin e tij ligjor për deklarimin e financimit dhe shpenzimet të fushatës zgjedhore. Më falni këtu, të bëj vetëm një ndërprerje për një shpjegim më të hollësishëm. Kur ne pretendojmë për goditjen rëndë, cënimin rëndë të mekanizmit të garantimit kemi parasysh një gjë. Ne do të pranonim në një rast, do pranonim gjobitjen ndonëse nuk kemi faj, çfarë do të na ndodhte nesër? Nesër ne do të hynim në procesin zgjedhor, të 153 kandidatët e Partisë Republikane, mbasi e dijnë që do të bëhet përgjegjëse Partia Republikane për mos deklarimet, do të refuzojnë, do të refuzojnë të sjellin, do ta neglizhojnë këtë proces. Unë nuk kam instrumenta të detyroj kandidatin që të vijë të bëjë deklarimin e tij. Nga ana tjetër ligji ka paraparë në mënyrë të qartë, taksative që kur ka marrë dijeni kandidati nuk ka arsye pse të dënohet subjekti, se në këtë rast ne do të bëhemi një trampolinë e shkeljes të rëndë dhe të përsëritur në çdo rast dhe do ta prishnim tërësisht mekanizmin. Në qoftë se unë nga pesë kandidatë vetëm njëri nuk më raportojë, nesër do të ndodhë që të pestë kandidatët të cilët mundet dhe të mos fitojnë në garë, pas zgjedhjeve nuk do të kenë asnjë predispozicion maksimal për të raportuar. Çfarë bëme? Nuk arritëm të vemë në funksion pikërisht këtë mekanizëm që e detyron. Nëse do të kishte nevojë për ndërhyrje, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka autoritetin e mjaftueshëm të kërkojë nisma legislative të ndryshojë.. të bëjë... Po për sa kohë Kodi Zgjedhor e ka normuar këtë marrëdhënie dhe ka identifikuar subjektin nuk mendoj që Partia Republikane përgjigjet për këtë shkak. Tani kam dhe disa shpjegime, arsyetime dhe argumente të tjera shtesë lidhur me pretendimet e sipërshënuara, sepse ato të sipër përmëndurat kanë lidhje me kërkesën ankimore. Vendimi nr. 224, pika 8, datë 7.12.2022 vjen në kundërshtim me rregullimet e ligjit, 10.279 datë 20.5.2010 “Për kundravajtje administrative” në të cilat përcaktohet se:...

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. K. Bele: Më fal të ndërpres, ju këto i keni paraqitur gjithashtu me shkrim në ankim apo jo? Apo janë parashtrimet tuaja shtesë?

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Jo, jo, jo kjo s'ka lidhje ky është një material që duhet dhënë shpjegime.


Z. K. Bele: Dakord, të lutem në mënyrë, nëse mundesh, telegrafike dhe ato mund t'i depozitoni dhe ne do t'i shqyrtojmë, megjithatë jeni në të drejtën tuaj ta parashtroni si ta mendoni më mirë.

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: E kisha në vëmendje këtë çështje por duke qenë se unë jam i detyruar të jap shpjegime, qofshin me shkrim ose me gojë dhe unë kam shënimet e mia të cilat mund t'i depozitoj më vonë thjesht një fotokopje e tyre por nuk janë as të rregullta. Më dëgjoni deri në fund se mbase është më normale, më komunikative kjo. Atëhere dhe një herë, pra "Ligji për kundravajtjen administrative" përcakton se:

1- Kundravajtja administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore dhe nënligjore të kryera në veprim ose mosveprim. Kjo dispozitë shpreh faktin e rëndësishëm se e drejta administrative nuk njihet përgjegjësi administrative në bazë të rezultatit, por duke marrë parasysh çështjen e fajit. Pra, shkelja administrative të konsiderohet kundravajtje duhet të jetë kryer me faj dhe të konsiderohet se është kryer nga personi që ka vepruar ose nuk ka vepruar me dashje apo nga pakujdesia. Pra, faj në çdo formë qoftë ai, duhet të vërtetohet dhe jo të prezumohet.

2- Procesi administrativ që i paraprin një vendimmarrje konkrete të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve konkretisht, nxjerrja e vendimit 224 duhet të zhvillohej në përputhje me rregullat ligjore si në substancë ashtu dhe në procedurë. Natyrisht

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*


parimet e përcaktuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative për rastin konkret në shqyrtim, duhet t'i marrë parasysh gjatë procedimit administrativ. Kështu:

a- Parimi i ligjshmërisë, kërkon që Komisioneri Shtetëror duhet të ushtronte veprimtarinë e tij brenda kufijëve dhe kompetencave që burojnë nga detyrimet që rrjedhin nga nenet 78/8, 90/4, 65/3 të Kodit Zgjedhor si dhe vendimi 13 i Komisionit Rregullator.

b- Parimi i drejtësisë, kërkon që Komisioneri duhet të vërtetonte gjendjen e drejtë të çështjes dhe për këtë qëllim duhet të vërtetonte të gjitha faktet që kishin rëndësi për nxjerrjen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm. Në këtë kuadër duke mbajtur parasysh nenin 19 të ligjit 10/279 "Për kundravajtjen administrative" nga ana e Komisionerit duhet që të gjitha provat që u paraqitën në seancën e shqyrtimit administrativ, nga ana e tij duheshin vlerësuar, argumentuar dhe se në përmbajtjen e vendimit të tij për konstatimin e kundravajtjes administrative të kryer nga Partia Republikane, duhej shprehur shpjegim i përmbledhur mbi faktet dhe provat ku u mbështet vendimi si dhe shkelja e kryer, duke u referuar dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi. Në vendimin e tij përfundimtar Komisioneri mbart detyimin që buron nga përmbajtja e nenit 88 dhe 100 të Kodit Procedurës Administrative që të vendoste dhe të shprehej në lidhje me të gjitha çështjet e ngritura nga Partia Republikane gjatë procedimit administrativ.

c- Vendimarrja e Komisionerit, referuar vendimit 224, në vlerësimin e Partisë Republikane është ndërmarrë në kushtet e moskonsiderimit të parimit të objektivitetit të sanksionuar në nenin 14 të Kodit të Procedurave Administrative, të cilët gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve të dhëna dhe provave që lidhen me procedimit administrativ.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*


3- Në vendimarrjen e tij gjatë procesit administrativ, Komisioneri Shtetëror nuk ka përmbushur detyrimet standarde mbi mënyrën e dokumentimit të gjetjeve të auditit, në fondet e përfituara të shpenzuara nga partitë politike sipas dispozitave rregullatore të parashikuara në vendimin 13. Në vështrim të raportit të auditit, për Partinë Republikane nga audituesja ligjore zonja Vullnetare Hoxha, nuk ka asnjë rubrikë e cila të shprehë parregullsi e parashikuar në raportin e gjetjeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në përfundim të raportit të saj, audituesja Vullnetare Hoxha ka konfirmuar se: fondet e akorduara dhe të shpenzuara për fushatë zgjedhore, për zgjedhjet parlamentare të datës 25 prill të Partisë Republikane në këtë datë, janë në përputhje, thotë audituesja, janë në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit, ky raport ndodhet në arkivin tuaj.

a - Referuar nenit 6 të vendimit 13, të Komisionit Rregullator “Për verifikimin dhe kontrollin financiar të subjekteve zgjedhore” shprehet se: Administrata e KQZ-së, pas marrjes së raportit të auditit bën verifikimin e raportit financiar duke krahasuar të dhënat me gjetjet e raportit të auditit.

b - Në pikën 3 të nenit 6 përcaktohet gjithashtu se, ju lutem pak vëmendje, jo se s’po më ndiqni po se kjo ka thellësisht ndërlidhje me procedurën se si do të konkludohet, s’kam shumë, nuk kam dhe shumë. Atëhere, në pikën 3 të nenit 6 përcaktohet gjithashtu se: nëse nga krahasimi ndërmjet raportit financiar të subjekteve me raportin përkatës të auditit për fushatën zgjedhore rezulton se ka mospërputhshmëri. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve urdhëron një riauditim nëpërmjet një audituesi të ri, detyrim të cilën Komisioneri për rastin në shqyrtim nuk e ka përmbushur. Pra, ju jeni përpara rrethanave të parashtruara në vendimin e Komisionerit, por që nuk vjen si produkt i një riauditimi.

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

c - Në vijim të pikës 4 të nenit 6 ju e dini si procedurë, audituesi i ri harton një raport përfundimtar, një procedurë kjo shumë e rëndësishme dhe e papërbushur përsëri nga ana e KQZ-së.

d - Sipas përmbajtjes së pikës 5 të vendimit si procedurë përcaktohet se pas përfundimit të procesit të riauditimit, administrata e KQZ i paraqet Komisionerit një relacion përfundimtar ku parashtron gjetjet nga verifikimi dhe kontrolli si dhe rekomandimet për masat e mëtejshme. Ashtu siç rezulton dhe nga përmbajtja e dispozitave si procedura, procesi i auditimit të subjekteve në çdo rast duhet të përmbushet nga audituesi ligjor të autorizuar, raporti i të cilave ka një risi themelore në këtë proces administrativ. Mënyra e hartimit të raportit të zgjedhjeve nga administrata e KQZ-së, duke u shmangur bashkëpunimin me audituesit, duke shkelur në flagrancë këtë kusht themelor për transparencën dhe paanshmërinë ka cënuar rëndë gjithë procesin administrativ që i ka paraprirë vendimmarrjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Duke vlerësuar këtë veprimtari haptazi në kundërshtim me aktet ligjore krijon bindjen e arsyeshme dhe të argumentuar për kundërshtimin e pikës nr. 8 të vendimit nr. 224 Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Përfundimisht, sigurisht kërkojmë mospranimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve sipas pikës 8 të vendimit nr. 224, faleminderit!

Z. K. Bele: Faleminderit! Keni ndonjë pyetje ju të sallës, vazhdojmë me subjektin tjetër. Partia Balli Kombëtar Demokrat. Nuk është prezent. Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë.

Z. S. Jenisheri, përfaqësues i PBPPSH: Partia jonë siç ju thashë pak përpara është pjesë e Koalicionit ABEOK ku përbëhet nga 4 parti. Partia Konservatore që është partia udhëheqëse, që drejton dhe përfaqëson këtë koalicion në çdo strukturë, qoftë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

edhe në KQZ e me rradhë, Partia Emigrantëve, Konservatorët, Ora e Shqipërisë edhe partia jonë Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve të Shqipërisë. Ne kemi plotësuar çdo porosi që edhe detyrimet që kemi si parti për në atë koalicion. Përfaqësues ka qënë dhe është zoti Kujtim Gjuzi dhe ne asnjë problem për asnjë gjë nuk kemi pasur. Megjithatë gjatë zgjedhjeve të 25 prillit 2021 koalicioni ynë e ka parë të arsyeshme për të bërë disa kërkesa ankimore. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk e ka parë të arsyeshme që këto kërkesa ankimore të shqyrtohen. Janë shqyrtuar, ka pas prej atyre kërkesave ankimore që janë shqyrtuar, po ka pas dhe prej atyre që akoma nuk janë shqyrtuar edhe sot e kësaj dite. Ato që janë shqyrtuar i kam këtu, ku ankesa ankimore ka përfunduar me datë 16 dhjetor...


Z. K. Bele: Më fal i nderuar.

Z. S. Jenisheri, përfaqësues i PBPPSH: Jo, 1 minutë sa ta mbaroj idenë të lutem.

Z. K. Bele: Ka lidhje me këtë.

Z. S. Jenisheri, përfaqësues i PBPPSH: Pra, ende nuk kanë mbaruar zgjedhjet e 25 prillit 2021. Procedurat, pra edhe sot e kësaj dite ne jemi në këto kushte kur ankimimet nuk kanë mbaruar. Kur nuk mbarojnë ankimimet neni 167 thotë “Pa mbaruar ankimimet nuk jepen mandatet” që do të thotë që ne i jemi drejtuar gjykatës dhe jemi tani në gjykatë. Jemi në gjykatë e kam sjellë dhe një dokument aty, që jemi në gjykatë për këtë gjë. Kur të mbarojnë të gjithë procedurat e votimit të 25 prillit 2021, atëhere koalicioni ynë do të përgjigjet për të gjithë detyrimet që kemi. Deri atëhere ne na duket e padrejtë që na jeni drejtuar, na kuptoni apo jo?! Meqenëse jemi drejtuar në gjykatë, mbaron në gjykatë dhe të gjithë shpenzimet me rradhë e me


**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

rradhë edhe atëhere do të paraqesim atë që kërkon ju. Pa të keqen e asaj që ne na duket një qëndrim aspak serioz nga KQZ-ja në lidhje me partinë tonë. Aspak serioz dhe do t'ju lutesha shumë që të bëjmë kujdes për këtë gjë, që në përputhje me ligjin, të zbatojmë ligjin, atëhere të na kërkon ne ligjin. Atëhere deri sa KQZ-ja nuk pranon të na shqyrtojë kërkesat tona sipas Kodit Zgjedhor... Atëhere ajo që përforcon më tepër arsyen për të cilën unë flas është këtu Fletorja Zyrtare dhe ku thotë që Gjykata Kushtetuese me vendimin e asaj nr. 38 me datë 09/12/2022 ka marrë vendim. Vendimi i saj thotë "Konstatohet ka vendos: konstatimin e cënimit të të drejtës kushtetuese të votës së emigrantëve në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë...". Ndërkohë që një nga partitë e koalicionit tonë është Partia e Emigracionit. Në këto kushte është e provuar që akoma nuk kanë mbaruar procedurat e zgjedhjeve parlamentare. Zgjedhjet parlamentare ku do të bëhen, meqenëse neni 160 i Kodit thotë që kur ka shkelje të ligjit janë të pavlefshme zgjedhjet, 161 thotë do të përsëriten zgjedhjet. Përsërisim zgjedhjet atëhere përfundimisht, partia jonë është pjesë e koalicionit dhe ne japim llogari këtu nëpërmjet përfaqësuesit tonë atje. Unë po ju tregoj edhe e fundit që te një kërkesë ankimore që kemi bërë dhe kemi qenë në Kolegjin Zgjedhor, gjykata zgjedhore nuk ka pranuar kërkesën e partisë tonë sepse, përfaqësuesja është koalicioni ABEOK me kryetar Kujtim Gjuzin. Kujtim Gjuzi ka të drejtë të vijë të flasë në emrin tuaj. Kështu që edhe nga kjo rrethanë dhe nga fakti që ende nuk kanë mbaruar procedurat e zgjedhjeve parlamentare, vetë Gjykata Kushtetuese ka deklaruar që janë antikushtetuese votimet që janë bërë në 25 prill dhe nuk e shoh të arsyeshme që të jemi thirrur sot për atë gjë, për këtë vendim që ka marrë Komisioneri dhe më duket se kjo arsye vlen dhe për të gjithë kolegët këtu.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. K. Bele: Tani të dëgjojmë kolegët, ju i parashtruat pretendimet tuaja, ju falenderojmë, ne i mbajtmë shënim të gjitha. Në qoftë se nuk keni argument tjetër shtesë të vazhdojmë me kolegun e rradhës.

Z. S. Jenisheri, përfaqësues i PBPPSH: Dakord, unë s'kam problem. Mua më duket i padrejtë vendimi që ka marrë Komisioneri dhe do t'ju lutesha juve që kur të mbarojnë procedurat siç thotë Kodi Zgjedhor, siç thotë Gjykata Kushtetuese, ne do përgjigjemi para ligjit, faleminderit!

Z. K. Bele: Vazhdojmë me Partinë Nisma Thurje. U relatuan në seancë, ju ndoshta s'ishit prezent që kërkesa juaj do të trajtohej në të njëjtën kërkim të bashkuar të të gjitha gjetjeve të subjekteve. Duke qenë se ju jeni prezent për Partinë Nisma Thurje.

Z. E. Shabani, përfaqësues i Nismës Thurje: Endrit Shabani! Atëhere vendimi që ka marrë Komisioneri si propozimi që ju ka bërë juve në raport me Nisma Thurje bazohet në dy argumente. Argumenti i parë është që shoqata KRIIK ka raportuar që disa kandidatë, pesë kanë kryer shpenzime në Facebook në vlerën nën 1.000 lekë të reja. 0 deri në 1.000 lekë që as KRIIK-u vetë nuk arrin t'i thotë me saktësi dhe teksti është i tillë, sipas KRIIK–ut thuhet “Vlera është caktuar në mënyrë arbitrare 1.033 lekë pasi shpenzimet nuk jepen me saktësi nga Facebook-u dhe ne e kemi të pamundur të evidentojmë vlerën e shpenzuar”. Pra, është bazuar vendimi pa na thënë ekzaktësisht sa paskan shpenzuar këta pesë kandidatë të cilët qartazi është e paqartë për ne, por qartazi është e paqartë dhe për KRIIK-un, besoj edhe për Komisionerin dhe instuticionin e KQZ-së se çfarë neni të ligjit këta kanë shkelur. Argumenti i dytë është që “nuk kemi dorëzuar raportet për shpenzimet për kandidatët që nuk kanë kryer asnjë shpenzim”. Tani në këtë pikë ne kemi dorëzuar raportet për shpenzimet

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

për gjithë kandidatët që kanë kryer shpenzime gjatë fushatës, por ka patur kandidatë që nuk kanë kryer shpenzime. Në këtë element unë besoj se këtu vlen për t'u interpretuar dhe nga ju, sepse ka dy çështje të rëndësishme. E para, koha ka qenë jashtëzakonisht e shkurtër, ne u paraqitëm me nje kod të ri zgjedhor, vendimi për udhëzimet në lidhje me raportimet ishte me 6 prill 2021. Ndërkohë dy javë më vonë ishin zgjedhjet. Deri para pak muajsh ka qenë e paqartë a duhet që kandidatët që nuk kanë kryer shpenzime të dorëzojnë formularët bosh, apo nuk duhet. Për ne ka qenë e paqartë. Pra, këtu nuk kemi të bëjmë me një dëshirë për të shkelur ligjin, nuk kemi të bëjmë me thelbin e asaj që Kodi Zgjedhor ka synuar të arrijë një qëllim, pra që është të shmangë përpjekjen për mos të qenë transparent me shpenzimet por kemi të bëjmë me nja paqartësi për interpretimin e ligjit. Ne kemi qenë jashtëzakonisht bashkëpunues me institucionin e KQZ-së kështu që nëqoftëse kjo ishte e detyrueshme, pra që ne duhet të dorëzonim dhe formular bosh për kandidatë që nuk kanë kryer shpenzime do të ishte më me vlerë që KQZ-ja të na informonte që duhet të plotësonim raportin me formularët e tjerë përpara se të vendoste një gjobë që është proporcionale me kushtet që ka subjekti ynë. Por dhe fakti që ne kemi marrë zero para nga fondet publike për këto zgjedhje. Kështu që për këto dy arsye duke qenë se s`kemi të bëjmë me shkeljen e thelbit të frymës ligjit, që nuk kemi të bëjmë me përpjekje për mos të qenë transparentë me KQZ-në, por kemi të bëjmë me një paqartësi në interpretim të akteve nënligjore. Unë do t'ju kërkoja që të vendosni kundër këtij propozimi të Komisionerit dhe ta anuloni këtë gjobë, faleminderit.

Z. K. Bele: Partia Bindja Demokratike.

Z. F. Topollaj, përfaqësues i PBD: Përshëndetje të nderuar, edhe Partia Bindja Demokratike si pjesa dërmuese e subjekteve zgjedhore është dënuar mbas nenit 178


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

pika 3 e Kodit Zgjedhor që parashikon se paraqitja për raportin me shkelje të rregullave dhe formatit të standartizuar të miratuar nga KQZ, dënohet me gjobë nga 50.000 deri 100.000 lekë. Pothuajse si pjesa dërmuese e subjekteve të tjera zgjedhore është konstatuar si shkelje fakti që nuk ka paraqitur raportet e kandidatëve. Së pari, unë mendoj që bihem dakord paraprakisht që është fjala në rast se kandidatët kanë pasur shpenzime dhe nuk i kanë raportuar ato. S'besoj se është fjala në rastin që kandidatët nuk kanë pasur shpenzime dhe KQZ-ja ngarkon partinë politike me gjobë për shkak se nuk ka paraqitur formalisht pra me zero shpenzimet e kandidatëve. Pavarisht se Bindja Demokratike në formatin e fundit të raportimit të KQZ-së i ka paraqitur të gjithë kandidatët e saj me vlerën zero të shpenzimeve. Unë dhe njëherë pra, për t'u futur në materie kam përshtypjen që ligji është shumë i qartë që parashikon një gjobë në rastin që ka shpenzime kandidati dhe ato janë fshehur dhe me këtë ngarkon partinë politike në një mënyrë, sepse ajo e ka pas detyrimin për t'i sjellë këto raporte. Rasti i Bindjes Demokratike dhe i subjekteve të tjera që kanë pasur të njejtin problem të mosdeklarimit të kandidatëve, jemi përpara një fakti krejt tjetër. Kandidatët tanë nuk kanë paraqitur raport shpenzimesh se nuk kanë pasur të tilla. Në raportin e auditit të KRIIK-ut edhe për Bindjen Demokratike është raportuar si gjetje që disa kandidatë nuk kanë deklaruar në mënyrë të veçantë nga partia shpenzimet në rrjetet sociale për sponsorizimin e postimeve në rrjetet sociale. Bindja Demokratike të gjitha këto shpenzime i ka futur dhe i ka paraqitur me shpenzimet e partisë, që do të thotë që edhe atje kur rezulton që një kandidat i yni ka shpenzuar 1000 lekë nga karta e tij e kreditit për të sponsorizuar një postim në Facebook, kandidati në këtë rast ka qenë postieri. Pra, i ka marrë lekët pranë partisë dhe ka përdorur kartën e tij të kreditit për të bërë sponsorizimin është në rolin e postierit nuk ka qenë shpenzimi i tij. Bindja Demokratike ka deklaruar rreth 500.000 lekë të reja për shpenzime në rrjetet sociale. Pra, kjo gjetje pëfshihet te fakti që kanë qenë


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

shpenzime të partisë dhe jo të kandidatëve. Gjithashtu, unë mendoj që rasti i penalizimit të subjekteve politike për shkak të mosdeklarimit të raporteve të kandidatëve edhe nëse ata do të kishin shpenzime dhe kjo do të ishte vërtetuar është i padrejtë sepse jemi në rastin e një ndëshkimi pa faj. Në të gjithë disiplinat e së drejtës përfshi dhe atë administrative nuk mund të ketë ndëshkim pa faj. Format e fajit janë vetem dylojëshe: ose me dashje, pra ti e shkel ligjin me dashje e kryen fajin me dashje ose nga pakujdesia. E zëmë një rast hipotetik që kandidatët kanë bërë shpenzime dhe nuk ja kanë raportuar subjektit politik. Çfarë faj ka subjekti politik që kandidati ka fshehur faktin që ka bërë shpenzime ai? Në këtë rast subjekti politik nuk ka faj, sepse as nuk e ka ditur shpenzimin e kandidatit. S'ka asnjë mënyrë për ta ditur shpenzimin e kandidatit dhe në kushtet që ai ka bërë të gjithë përpjekjet për ta informuar kandidatin që ti ke detyrimin ti deklaroj shpenzimet, detyrimet e partisë janë mbyllur në këtë pjesë. Pastaj këto janë detyrime të kandidatit dhe në dijenin time ka dhe një vendim të Komisionit Rregullator që tregon mënyrën se si kandidatët duhet të paraqesin pranë partive politike shpenzimet e tyre. Në çastin që asnjë kandidat nuk ka paraqitur pranë partisë politike, pra në këtë rast Bindjes Demokratike shpenzimet e tij, si mundet Bindja Demokratike ta dinte, ta kuptonte që këta kandidatë kanë bërë shpenzime edhe nëse do të kishin bërë, pavarësisht se në rastin tonë, jemi në rastin që ata s'kanë bërë shpenzime. Gjithashtu unë mendoj që ndëshkimi është jo propocional. Propocionaliteti është një parim jo vetëm i Kodit të Procedurave Administrative, për ndëshkimet administrative, por është dhe një parim kushtetues sa herë kemi kufizimin e të drejtave themelore. Kam përshtypjen që biem dakord që nëse subjekti politik do të ngarkohet me këtë gjobë, ky është një kufizim që i ndodh atij dhe kufizim i cili duhet të jetë propocional. Ju vë në vëmendje që Partia Bindja Demokratike dhe pjesa dërmuese e subjekteve kanë përfituar për fushatën zgjedhore që kaloi afërsisht 1.400.000 lekë. Pjesa më e madhe e partive pra,


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

të reja dhe të vogla, nga të cilat gjysmat e kësaj shume merren në këtë rast në formën e ndëshkimit për mos pëmbushjen e formatit dhe rregullave të deklarimit shpenzimeve. Ndërkohë që jo vetëm është jo propocionale, por nuk kuptohet cili është formati që nuk kemi përmbyshur dhe cili është rregulli që nuk kemi përmbyshur në këtë rast. Pra, ndëshkimi është haptazi jo propocional dhe në gjykimin tim bie ndesh edhe me, ose më tepër se bie ndesh kam përshtypjen, do të ishte më e saktë të thosha që ju duhet të keni parasysh edhe nenin 15, në vendimmarrjen tuaj, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se “organet e pushtetit publik në përmbyshje të detyrave tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”. Që do të thotë që biem të gjithë dakord, që ligji është shumë jo propocional, por edhe i paqartë në rastin e ndëshkimit të partisë për shkak se kandidatët e saj nuk kanë deklaruar shpenzime, në rastin që ata nuk i kanë deklaruar dhe i kanë mbajtur të fshehta. Kështu që unë mendoj se edhe në respektim të nenit 15, ju duhet të keni parasysh që të përmbyshni të drejtat themelore të partive politike, në këtë rast çënohen rëndë dhe nuk mund të kufizohen për shkak se disa subjekte të tjera nuk kanë përmbyshur detyrimet e tyre. Për të gjithë këtë arsye mendoj që propozimi i Komisionerit është i pasaktë dhe të paktën për ato parti politike që ndëshkohen se kandidatët e tyre nuk kanë paraqitur raportet, kjo gjobë duhet të anulohet. Përpara se të bënte një kërkesë për vendosje gjobash për mosdeklarimin e shpenzimeve të kandidatëve, unë mendoj që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të duhet të vendoste disa rregulla ku të qartësonte ligjin me akte ligjore, se si kandidatët duhet të deklarojnë shpenzimet e tyre dhe t’i vishte ata me përgjegjësinë nëse nuk përmbyshin detyrimet e tyre. Ju vë në vëmendje që në fushatën e ardhëshme zgjedhore, të zgjedhjeve lokale çdo parti politike do të ketë më shumë se dy-tre mijë kandidatë për këshilla bashkiakë dhe është realisht e pamundur, edhe ligji nuk do të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

ishte logjik. Nuk do ta respektonin në mënyrë logjike nëse do të ngarkonit partinë politike për faktin se një apo dy nga kandidatët, nga dy mijë kandidatët e këshillave bashkikë nuk raportojnë pranë partisë politike shpenzimet e tyre. Për të gjitha këto arsye jemi kundër propozimit të Komisionerit.

Z. K. Bele: Vazhdojmë me Partinë Socialdemokrate. Nuk është.
Po Lëvizja Demokratike Shqiptare nuk është?

Z. K. Bele: Po më fal se ishte në fund të fletës. Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare ka prezent? Jo dakord! Mirë Partia Socialdemokrate?

Z. R. Preçi, përfaqësues i PSD: Gati, gati.

Z. K. Bele: Po ju lutem.

Z. R. Preçi, përfaqësues i PSD: Të nderuar anëtarë të KAS-it edhe kolegë, Partia Socialdemokrate në përputhje me detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga Kodi Zgjedhor ka bërë një përgatitje paraprake me kandidatët sidomos të dy-tre qyteteve të mëdha Tiranës, Shkodrës dhe Korçës dhe janë sqaruar sipas kodit sepse jam dhe vetë përfaqësuesi i partisë këtu në KQZ. Me thënë të drejtën i është bërë e qartë kandidatëve dhe jam dakord me mendimin e kolegëve, se cilat janë detyrimet që kanë ndaj partisë dhe KQZ-së për të njoftuar, për të sjellë si të thuash kopjet të faturave ose shpenzimeve të partisë. Mirëpo cila është ajo PSD-ja? Këtu kam dy dënime. Dy dënime po i quaj se unë jam matematicien nga profesioni.. shiko njëri është te vendimi 224, një është në bazë të kodit është neni 88, pika 7. Ne kemi pasur një rimbursim ose një dhënie paraje të partisë 1.630.000 lekë të reja. Meqenëse ne


**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

faktikisht, të jem realist kam një arsye, kemi dorëzuar nga që kandidatët nuk na dhanë... Jam dakord me mendimin e shokëve nuk sollën informacionin e duhur në kohë dhe ne si parti në këto kushte vlerësuam të pamundur t'i rimbursojmë kandidatët që do të shkelnin ligjin. Ata i kanë sjellë disa i kemi mbledh pas afatit. Në tabelën e shpenzimeve kemi dorëzuar zero në kolonë dhe financimi prej 1.632.000 është ndalur komplet, është neni, sigurisht. Mirëpo ne këtë e kemi pasqyruar me atë pasqyrën financiare vjetore të partisë, e kemi pasqyruar si zë aty te shpenzimet. Kështu që jemi gjobitur me 60.000 lekë. Mirëpo është tjetra që në bazë të nenit 173/3 në qoftë se dorëzohen me vonesë. Këtu është ndaluar si të thuash, më fal është ndaluar diferenca komplet, është ndaluar në bazë të kësaj. Po kështu jemi gjobitur për vonesën, jemi gjobit 60.000 lekë. Tani ne edhe e shtrojmë dhe e them shoqërore kështu. Ne e kemi pas s'po përmend ishte koha e pandemisë të them të drejtën dhe këtë e kërkoj nga ju... financierja ka qenë sëmure jashtë me gjithë të shoqin s'po futemi e të zgjatemi por kemi pas dhe vdekje.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. R. Preçi, përfaqësues i PSD: Pothuajse kam qenë vetëm në këtë parti, jam përpjekur kolegët nuk kanë sjellë rezultate dhe jemi detyruar që të gjitha shpenzimet dhe njëherë të mos e zgjasë më shumë i kemi pasqyruar në atë vjetoren. Jam dakord edhe me mendimin edhe të shokëve që thanë nuk kemi krijuar akoma kulturën edhe e kandidatëve që të dorëzojnë dhe të raportojnë rregullisht në parti, kolegët e mi që kanë kandiduar duke marrë vesh që tek partia ka një rast pandemie kështu. Filluan vetëm me telefon me gjëra dhe ky është fakti. Unë kërkoj që të paktën njera nga këto 1 milion e 600 mijë mos të ndalohen, gjobën jam dakord ta pranoj në emër të partisë që të mos të zgjatet më shumë ose po them një gjë që vonesa ka qenë me lënë zërat dhe po e quaj nuk e di tani, ju jeni jurist të gjithë po e quaj që janë dy dënime, njërën na falni po e kërkojmë ne. Faleminderit. Duhet marrë parasysh edhe koha, edhe kushtet ishim në kushte pandemie..

Z. K. Bele: Faleminderit! Të vazhdojmë, në kushte pandemie ne kemi ardhur. Dikush me maskë dikush pa maskë sipas hapësirave të ligjit jemi munduar të bëjmë më të mirën. Duke e thënë këtë, ne do e shqyrtojmë rast pas rasti sipas atyre që na është para shtuar nga Komisioneri dhe duke reflektuar edhe në prapësimet tuaja. Kështu që ju falenderojë për ato argumente që sillni! Partia Balli Kombëtar ju lutem, po faleminderit!

Z. A. Alimadhi, përfaqësues i PBKD: Faleminderit zoti kryetar! Në fakt unë jam plotësisht dakord me çfarë parashtruan përfaqësuesit e subjekteve politike. Në fakt ne si subjekt politik kemi dorëzuar 153 kandidatë nga 153 për 3 kandidatë i kemi raportuar shpenzimet tona për pjesën tjetër pastaj për 150 kandidatë nuk kanë bërë shpenzime. Madje duhet tu them që asnjë prej tyre madje nuk kemi marrë as votën

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

e tyre dhe është e çuditshme që të paguajmë gjobë tashmë 6 milion të vjetra nuk kemi marrë as votën dhe të paguajmë lekët. Mua kjo më duket shumë e çuditshme, duhet të shtojë faktin tjetër që jemi subjekti që nuk e prekim buxhetin e shtetit dhe kërkojmë këtu që edhe ju të keni në fakt mirësinë tuaj për të mos na penalizuar ne ose për të rrëzuar masën administrative që ka propozuar Komisioneri. Unë mund t'iu them një gjë, në fakt ligjet tona kanë mbi ngarkesë, tjetër gjë është Kodi Zgjedhor dhe tjetër gjë është ligji për partitë politike. Nuk më kujtohet neni përkatës në të cilat thuhet shprehimisht që shteti ose organet vendore marrin masat për të mbështetur subjektet politike. Unë nuk e di dhe nuk mund ta kuptoj ashpërishtë e Kryekomisionerit që ka propozuar këtë masë administrative për të gjitha këto subjekte politike në të cilat i japin kuptim demokracisë së vërtet në Shqipëri. Unë mendoj që Kryekomisioneri është në linjën e mëparshme të këtyre subjekteve në të cilën kërkojnë të diskriminojnë, të penalizojnë që këto subjekte politike të mos ta kryejnë lirisht aktivitetin politik të tyre madje edhe me shpenzimet e tyre. Të ndodhur në këto kushte kërkojë nga ju të nderuar anëtarë të KAS-it, rrëzimin e kësaj mase është e pa mbështetur në ligj, nuk ka logjik në kuptimin e proceseve demokratike, dhe kërkojë rrëzimin e saj dhe mos penalizimin të paktën të subjektit tim por edhe të të gjithë përfaqësuesve të tjerë. Do ti bëni një proces ose do ti jepni një orientimin tuaj për proceset demokratike në Shqipëri. Ne do ta vazhdojmë jetën tonë politike ashtu siç e kemi vazhduar. Me të mirë apo me të keq, do ti japim kontribut këtij vendi, por ju lutem nuk pranojmë penalteti si në kohën e sistemit komunist ose në burg ose paguaj, ose të burgosesh ose të vritesh. Këtë ka shprehur Komisioneri. Faleminderit!

Z. K. Bele: Faleminderit! Pyetje nga kolegët, besoj subjektet i mbaruam.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. E. Çefa: Unë kam një pyetje për stafin lidhur me pretendimet e subjektit parafolës. U pretendua që nga 153 kandidatë për 3 është bërë deklarimi dhe nuk është bërë për 150. Ndërkohë në propozimet e komisionerit thotë që nuk është paraqitur në formën e kërkuar për 152 kandidatë. Tani thjesht një saktësim shifrash dhe finale desha. Po pyes administratën, por edhe ju mund të përgjigjeni nëse keni informacion nuk ka problem.

Z. Y. Merkaj: Gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar që nuk është dorëzuar raportet financiare për 152 kandidatët si dhe formati përmbledhës.

Z. K. Bele: Më fal se edhe unë kam të njëjtën pyetje, kur unë shoh të gjitha gjetjet pothuajse në të gjitha nuk janë dorëzuar në disa raste thuhet 153 kur thonë nuk janë dorëzuar 153, keni parasysh që nuk janë dorëzuar fare apo mund të jenë 5 të dorëzuara por jo në format. Pra e kemi të evidentuar këtë të dhënë?


Z. A. Alimadhi, përfaqësues i PBKD: Të përgjigjem unë, e kam të qartë mos u merrni me këta, nuk e kam me inat por...

Z. K. Bele: Ishalla gabon ai edhe të ndihmonë.

Z. Y. Merkaj: Atëhere, ne kemi konstatuar gjatë hetimit administrativ që janë dorëzuar për disa kandidatë dhe nuk është dorëzuar për 153 në rastin që pyetet juve. Se nëse nuk do të ishte dorëzuar për asnjë kandidatë atëherë do të ishim në paragrafin e parë.

Zbardhi materialin e inçizuar

Ardita CAMI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KOZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. K. Bele: Unë kam dorëzuar për 3 thotë jo për 150 sepse 3 kishin shpenzime, 150 nuk kishin shpenzime. Ky është i ndryshëm nga rasti kur dikush ka dorëzuar dhe nuk ka qenë sipas formatit. Pra, ne duam të evidentojmë të njëjtën gjë tha edhe zoti Shabani është çështja e evidentimit të situatës kur e ka dorëzuar por jo në format ku ligji e përcakton si një shkelje dhe nuk ka dorëzuar fare. Këtë duam të kuptojmë.

Z. Y. Merkaj: Atëherë, kanë qenë 153 kandidatë që nuk kanë dorëzuar por partia subjekti ka dorëzuar vetëm raportimin përmbledhëse e partisë si subjekt kurse për kandidatët nuk ka dorëzuar dhe prandaj edhe neve e kemi parashikuar tek paragrafi...

Z. L. Braho: Tek përmbledhësja janë edhe këta dy kandidatë?

Z. Y. Merkaj: Jo, nuk janë.

Z. L. Braho: Janë reflektuar si shpenzime të partisë, por si shpenzime janë reflektuar.

Z. Y. Merkaj: Jo, pra të kandidatëve jo. Partia ka depozituar shpenzimet e saja.

Z. L. Braho: Po këto shpenzime që kanë bërë X kandidatë mos kanë qenë të reflektuara si shpenzime të partisë.

Z. Y. Merkaj: Jo, nuk janë.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. A. Alimadhi, përfaqësues i PBKD: Mundet ta shpjegojë këtë situatë, në fakt ne kemi dorëzuar raportin dhe në raport kemi vënë tre emra që kanë shpenzuar paratë. Pra, jam unë, Kujtim Lamaj edhe Arlinda Toro. Pra, tre kandidatë të cilat ato në fakt i kam paguar unë me thënë të drejtën po ligji atje ka 500 dhe i kemi ndarë. E mbaj mend mirë. Kështu që këta të tjerët nuk na kanë dhënë votën, unë habitëm sse si do të na gjobisni ju kur këta, ose do të miratoni propozimin e Kryekomisionerit këta nuk na kanë dhënë votën, ju thoni kanë shpenzuar do merrni masa administrative nuk e di. Do të na ndihmoni pak në proces po....

Z. E. Çefa: Këto i zgjodhët ju apo i zgjodhëm ne?

Z. A. Alimadhi, përfaqësues i PBKD: Jo ne i zgjodhëm. Por mos harroni që kjo është për herë të parë që aplikohet në Shqipëri me thënë të drejtën. Edhe ne subjektet politike nuk është se kemi një funksionar të përcaktuar i cili kryen këto procedura, i cili sigurtisht që mund të ketë mangësi nga ne por ama kur ne të gjitha këtu partitë politike i bëjmë një shërbim vendit tonë. Ju duhet të keni një logjik mendoj unë që të na ndihmoni në këtë proces. Se tani nuk besoj të jetë qëllimi që të penalizojmë këto subjekte mos të bëjnë aktivitet por edhe 6 milion apo 11 apo 16 sinqerisht për ne subjektet që e bëjmë vetë fushatën tonë janë të vështira.

Z. L. Braho: Të bëj edhe një pyetje tjetër unë. Përveç këtyre akteve që ka nxjerrë KQZ, Komisioneri, Komisioni Rregullator, apo parashikime në Kod Zgjedhor. Keni pasur njoftime nga KQZ të herë pas hershme për të plotësuar këto detyrime ligjore?

Z. A. Alimadhi, përfaqësues i PBKD: Jo në këtë rast jo nuk kemi pasur.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. L. Braho: Pra, nuk keni pasur asnjë njoftim nga KQZ.

Z. A. Alimadhi, përfaqësues i PBKD: Madje edhe formularin nuk kemi pasur dijeni për ta plotësuar se po ta kishim formularin të gatshëm, sinqerisht do ta kishim plotësuar atë. Duhet të jetë pak e vështirë për 153 por kur i kemi marrë firmat, kur kemi plotësuar dokumentacionin bashkëngjitur propozimit të kandidatit do ta realizonim edhe këtë procedurë. Kështu që është për herë të parë që aplikohet edhe .. Faleminderit juve!

Z. L. Braho: Faleminderit!

Z. I. Rusmali: Desha ta nisë fillimisht me një pyetje për administratën, neni 88 pika 6 parashikon që për subjektet që marrin financim buxhetor nga shteti lidhet me ta akt marrëveshje financimi. I keni lidhur ju akt marrëveshjet e financimi me subjektet kur i keni dhënë financimin.

Z. Y. Merkaj: Po.

Z. I. Rusmali: Mund ti disponojmë ne ato aktmarrëveshje?

Z. Y. Merkaj: Po.

Z. I. Rusmali: Për përfaqësuesin e Partisë Socialdemokrate kam një pyetje unë. Ju kërkuat që neve të shohim mundësinë që të ulemi nën minimumin ligjor të ndëshkimit të gjobës. Sepse jemi të vetëdijsëm për faktin që gjobat e vendosura për shkeljet e konstatuara janë në minimumin e tyre ligjor apo jo të gjithë? Ju kërkuat që ne të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

vendosnim nën minimumin ligjor. Keni një argument juridik që të na bind ne edhe pse duhet të shkojmë nën minimumin ligjor, argument juridik, jo politik, pra një bazë ligjore për ne që të shkojmë nën minimumin ligjor. Me mikrofon të lutem, se ka rëndësi!

Z. R. Preçi, përfaqësues i PSD: Ngaqë jemi të vonuar në paraqitje, kemi paraqitur një kollonë thashë zero. Ne na duket që për të njëjtën gjë jemi dënuar dy herë, gjobitur gjobitur 600 mijë edhe ndalesë edhe fondi i financimit.

Z. I. Rusmali: Në rregull argumenti juaj në qoftë se mund ta them unë me fjalët e mija ndoshta jemi përpara një korrigjimi nuk ka lidhje me KAS që të shkojë drejt minimumit ligjor por të shqyrtojë thelbin e çështjes dhe të konstatojë që mungon faji në një shkelje ose në një shkelje tjetër apo jo?

Z. R. Preçi, përfaqësues i PSD: Po.

Z. I. Rusmali: Në rregull, faleminderit! Pyetje e përbashkët për Bindjen Demokratike dhe për Nismën Thurje. Ndoshta mund të përdorim imagjinatën për ti dhënë përgjigje pyetjes. Por më listoni ju lutem, një listë veprimtarish elektorale të një kandidati listë të gjatë ose të shkurtër me shpenzime zero. Një veprimatri, dy, tre, pesë, dhjetë veprimtari elektorale që kanë shpenzime zero, që të mund ta kuptojmë?

Z. F. Topollaj, përfaqësues PBD: Pjesa dërrmuese e veprimtarive elektorale edhe politike janë me shpenzime zero sepse është vullnetare.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. I. Rusmali: Me shembull!


Z. F. Topollaj, përfaqësues PBD: Takimi me njerëzit, biseda me njerëzit

Z. I. Rusmali: Të lutem veprimtaria ka elementët e vet, domethënë veprimtari vullnetare nuk ekziston në kuptimin financiar sepse vullnetarizmi kostohet thonë udhëzimet që keni ju në dispozicion. Vullnetarizmi kostohet në qoftë se juve ju jepet një mjedis me qera falasi për dashamirësi ajo do të marri kosto e një mjedisi falasi jo me qera. Do të marri koston e qerasë pavarësisht se ju e keni pa lek do të konsiderohet donacion. Kështu thonë udhëzimet tuaja.

Z. E. Shabani, përfaqësues i Nismës Thurje: Të sqarojmë një gjë që ju nuk e dini...

Z. I. Rusmali: Të sqarojmë këtë që dua unë njëherë jo atë që nuk e di unë. Unë nuk di shumë gjëra por unë kam nevojë për këtë çështje të sqarojë disa gjëra që më nevojiten mua dhe veprimtaria ka element të vetët dhe unë po përpiqem që të kuptojmë koston zero të veprimtarisë. Kandidati juaj për shëmbull do shkojë me një takim me 20 zgjedhës në një lagje të Tiranës, do shkojë në këmbë, harxhon energjitë e veta, dhe konsumon këpucët, do shkojë me autobuz harxhon biletën kosto është bileta e autobuzit, do shkojë me mjetin e vetë personal harxhon karburantin e makinës dhe konsumin e makinës, do shkojë me taksi harxhon çmimin e taksisë. Po nuk e ka koston zero. Pastaj kur shkon atje në aktivitet e ka në rrugë aktivitetin, e ka në një shesh të një insitucioni, e ka në një kafene ka koston e mjedisit. Pastaj kur futet brenda dhe ka 10 veta brenda dhe ju jep një kafe të gjithëve nga xhepi i vet ka koston e kafes. Pra imagjinoni një veprimtari çfarë do

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

qoftë ajo, jo një, pesë, dhjetë, që e kanë koston zero. Që ne të kuptojmë se sa të mënçur janë kandidatët tuaj dhe sa budallenj kanë qenë kandidatët e tjerë që kanë pasur shpenzime. Po veprimtari me koston zero në të gjithë elementët përbërës të vetët.

Z. E. Shabani, përfaqësues i Nismës Thurje: Zoti Rusmali ligji na ka detyruar që ne të dorëzojmë një listë me kandidatë përtej kapacitetit të Parlamentit të Shqipërisë për të pasur deputet. Pra, unë besoj që çdo njeri me mend në kokë e kupton që kandidati i Nismës Thurje me numër 153 ka 100% shanse për të mos u futur kurrë në parlament. Pra ky detyrim ligjor na ka detyruar që një pjesë e aktivistëve tanë që kanë bërë zero aktivitet të rregjistrohen për të plotësuar këtë detyrim ligjor. Pra, në qoftë se ligji do të na kishte krijuar kushtet që ne të garonim aq kandidatë sa ne donim ne do kishim pasur vetëm 5 kandidatë të cilët kishin potencialisht një shans për tu bërë deputet. Për sa kohë ligji na ka vendosur në këtë qoshe neve kemi detyruar që edhe simpatizantë edhe aktivist edhe staf edhe njerëz të tjerë, të bëjnë një nderë për të kaluar këtë pengesë ligjore artificiale që fillon me ligjin. Këta njerëz nuk kanë bërë aktivitet kanë bërë zero aktivitet dhe për pasojë kanë bërë zero shpenzime. Tani këtu fryma e ligjit, unë jam pro transparencës, fryma e ligjit dhe synimi i gjobës është për të penguar mungesën e transparencës për të na detyruar në që të jemi transparent. Këtu ne nuk kemi fshehur asnjë gjë, nuk kemi pasur synimin, në qoftë se KQZ stafi do të na thoshte shiko nuk keni sjellë, se kemi dorëzuar gati 10, nuk kemi sjellë 150 do kishim sjellë 150 bosh. Është mungesë informacioni, është mungesë koordinimi, kemi të bëjmë me një kod të ri, kemi të bëjmë me udhëzime të reja, në një kohë jashtë zakonisht intensive.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita CAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. I. Rusmali: Të lutem unë e mora përgjigjen. Lista e personave që e kanë pasur shpenzimet zero janë personat që nuk kanë zhvilluar veprimtari...

Z. E. Shabani, përfaqësues i Nismës Thurje: Aktivitet politik.

Z. I. Rusmali: Po. Kjo është e qartë. Tani, siç lexojmë neve nga materialet që na janë servirur ka pasur, përsëri pyetja është për ju të dy. Ose për ju vetëm se ju e thatë këtë që skeni.... ka pasur një shtyrje të afatit të raportimit për shkak të vështirësive që ka pasur në komunikimin midis subjekteve besoj unë dhe pastaj për t'iu dhënë mundësinë subjekteve që të rikapin afatin, të plotësojnë dokumentacionin, ta rregullojnë dokumentacionin kjo periudhë e shtyrjes ka qenë e vetëdijshme për ju. Domethënë ju ka thënë njëri që e kemi shtyrë afatin dhe ... Nuk iu ka thënë njeri...

Z. L. Braho: Zoti Rusmali kush afat është shtyrë ai 60 ditori i parë apo afati i audituesit, se edhe unë nuk e kam të qartë këtë?

Z. I. Rusmali: Nga materiali del që KQZ ka bërë shtyrje afati. Komisioneri ka bërë shtyrje afati. Të na e sqarojë administrata?

Z. L. Braho: Zoti Merkaj është shtyrë afati 60 ditor, apo mësa kuptova unë është shtyrë afati 30 ditor për audituesit. Pra ka pasur auditues që nuk e kanë mbyllur dot auditin për 30 ditë dhe

Z. Y. Merkaj: Mesa mbaj mend unë është për auditimin, është shtyrë për auditimin.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. L. Braho: Është vetëm për auditimin pra nuk është se janë favorizuar palët.

Z. I. Rusmali: Mirë dakord. Domethënë ju nuk keni pasur komunikim me KQZ-në dhe nuk keni marrë udhëzime nga KQZ-ja për plotësimin edhe për kandidatët.


Z. E. Shabani, përfaqësues i Nismës Thurje: Në rastin e Nismës Thurje ne kemi pasur diçka ka ndodhur në lidhje me postën sepse edhe këtë vendimin e fundit ne e kemi marrë vesh nga media. Pra, sot e kësaj dite ne ende nuk e kemi marrë me postë këtë gjë, po besoj që ky është rast specifik për Nismën Thurje për shkak se ne kemi ndryshuar selinë edhe ndoshta kjo mund të jetë objekti, nuk e di teknikalitetet po ne kemi pasur vështirësi të vazhdueshme në komunikim me KQZ-në për këtë çështje.

Z. I. Rusmali: Mirë faleminderit! Ndoshta edhe dy pyetje për zotin Madhi dhe për zotin Jenisheri. Ju keni garuar në ato zgjedhje si pjesë përbërëse e koalicionit dhe ju referuat tek një dispozitë e Kodit Zgjedhor që thotë: “Që detyrimet për subjektin zgjedhor i plotëson partia udhëheqëse e koalicionit”. Me duket se e thatë të dy këtë gjë.

Z. S. Jenisheri, përfaqësues i PBPPSH: Ne nuk kemi garuar atje si parti po kemi dorëzuar 140 deputet. Ne kemi garuar tek lista, lista jonë është në listën e koalicionit dhe sipas ligjit, partia që udhëheq ajo parti komunikon me KQZ. KQZ sa herë që i kam prurë unë letrat më ka thënë jepja atij juristit të ABOK.

Z. I. Rusmali: E kuptova. Kjo ishte në parantezë nuk e kam bërë pyetjen akoma.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. S. Jenisheri, përfaqësues i PBPPSH: Unë jam në rregull me koalicionin dhe koalicioni është në rregull me ju. Ato tre partitë e tjera nuk... por unë e kuptoj shumë mirë që administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka problem se unë e kam çuar në gjykatë. Dhe po vazhdon gjykata dhe Gjykata Kushtetuese thotë që këto zgjedhje të 25 Prillit 2021 janë antikushtetuese dhe kur janë antikushtetuese kur të mbarojë përsëritja e zgjedhjeve ne kemi me u përgjigj për shpenzimet që bëhen. Ju nuk pranoni ne bëmë kërkesë ankimore ti nuk pranoni, prit se unë do flas, unë bëj kërkesë ankimore ti nuk mi pranoni kërkesat. Ti ma kërkon mua të zbatoj ligjin kur ti ligjin nuk e zbaton.

Z. I. Rusmali: Nuk e dua më përgjigjen nga ju zoti Jenisheri, në qoftë se nuk respektoni trupën këtu, juve bëni gabim se ne jemi këtu për të zgjidhur

Z. S. Jenisheri, përfaqësues i PBPPSH: Kam të drejtë të flas ti nuk më lë të flas, i kam bërë kërkesat...


Z. I. Rusmali: Nuk ke të drejtë të flasësh ...

Z. S. Jenisheri, përfaqësues i P.Pensionistëve: Ti kam bërë kërkesat, ti nuk më lë me i shqyrtuar dhe të thotë Kodi Zgjedhor për përsëritje zgjedhjesh.

Z. I. Rusmali: Në rregull! Zoti Madhi, dispozita e Kodit Zgjedhor që përcakton detyrimin për partinë udhëheqëse të koalicionit që ju iu referuat do të thotë që detyrimi për raportim nuk bie më mbi partitë politike anëtare të koalicionit?

Zbardhi materialin e inçizuar

Ardita ÇAMI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Në kuptimin tonë po, po nëse mund të ketë divergjencë mbi këtë kuptim do të thotë prapë paskemi disa dizpozita që nuk kanë qenë të qarta. Prova që kemi depozituar tek ju lidhur vetëm me këtë kandidat Ludovik Hasani për Shkodrën është një komunikim i vazhdueshëm me financierin e Partisë Demokratike kur i themi shpejt vazhdoni të komunikoni me Ludovik Hasanin për të prurë dokumentat. Që do të thotë ne respektonim pozicionin që kishte statusin e veçantë që kishte partia si parti udhëheqëse. Së dyti, pa dashur të flas për ti dhënë përgjigje ezauruese kësaj pyetjes suaj pa dashur të flas për teknikat të gjitha partitë politike kanë teknikat e tyre elektorale si të përfshihet në lista të përbashkëta dhe sigurisht një pjesë e kandidatëve ishin jo disponibël përpara kërkesës që rregjistrojmë ne si parti se thonte nuk kam punë unë me ty, nuk të njoh si kështu janë taktikat që besoj secili nga ju ka goxha dijeni për këtë fushë. Pra, unë e thërrisja kandidatitn kush je ti mor thotë nuk dua ta di për ty fare unë jam me Partinë Demokratike pavarësisht nga raporti

Z. I. Rusmali: Në vlerësimin tuaj, detyrimi është për partinë udhëheqëse të koalicionit dhe juve nuk keni detyrimin për raportim.


Z. A. Madhi përfaqësues i PR: Ekzakt.

Z. I. Rusmali: Juve keni bërë raportim?

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Ne kemi bërë raportim financiar të partisë.

Z. I. Rusmali: Pse?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Një sekondë, raportimin financiar të partisë dhe duke identifikuar pesë kandidatët tanë e kishim të mundur të komunikojmë dhe të zbatonim detyrat, detyrën e ngarkuar nga ligji pavarësisht sepse nuk i besonim shumë do ta ndihmonim edhe aleatin tonë në koalicion që të operonim. Kur erdhi puna tek ky kandidati i fundit se për të gjithë të tjerët arritën erdhën ...

Z. I. Rusmali: Të lutem shumë nuk e kuptoj dot, përgjigjen në qoftë se përgjigja shpërndahet. Ose e keni detyrimin për raportim sipas ligjit dhe bëni raportim sipas ligjit ose nuk e keni detyrimin për raportim sipas ligjit dhe nuk bëni raportim. Në qoftë se ju thoni nuk e keni detyrimin por kemi bërë raportim duhet të më shpjegoni pse pa pasur detyrim keni bërë raportim.

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Atëherë ende vazhdoj në interpretim të dispozitës të them që nuk është përgjegjësi e partive ose subjekteve të veçanta që bëjnë pjesë në një koalicion këtë e ka thënë hapur ligji. Sa i takon komunikimeve bashkëveprimit që kemi ne brenda partive politike. Unë mora përsipër të bëj raportimin e kësaj dhe ta çoj. Sepse nëse nuk do ta kisha dërguar nuk do më akuzonin.

Z. I. Rusmali: E çonit ku, tek Partia Demokratike?

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Jo, jo tek Partia Demokratike, se e bëmë dje raportimin u bë këtu sepse shiko çfarë

Z. I. Rusmali: Po pse kur nuk e keni detyrim...

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Atëhere, po ju them procedura parashikon kështu deputeti kandidati për deputet dorëzon materialet tek kryefinancieri i një partie politike dhe kryefinancieri e merr bruto këtë material dhe e depoziton në KQZ. Tani katër nga këto që ishin njëkohësisht të identifikuar me listën zgjedhore si deputet të Partisë Republikane erdhën dhe i bënë këto punë, dhe ne i morëm të katërt këto dhe ia dërguam KQZ-së i pesti refuzoi ta sjelli. Pra, kjo është kaq e thjeshtë por nëse më pyesni për kuptimin e ligjit përsëri po ju them e gjithë kjo tregon një paqartësi mungon sanksionimi i plotë, i saktë duket më shumë ka dëshirë për të gjobitur ses a për të mos përsëritur më këto fenomene që kanë ndodhur dhe që vijnë nga paqartësia.

Z. I. Rusmali: Pika 3 e nenit 90, jo pa shkuar atje, kur jeni regjistruar ju keni depozituar identitetin e financierit të partisë në KQZ? (përgjigje pa mikrofon) Në rregull. Pika 3 e nenit 90 kërkon nga subjekti zgjedhor që të marrë masa për koordinimin e informacionit nga kandidatët e tij gjatë fushatës zgjedhore dhe të vendosë rregulla dhe penalitete të brendshme nuk po flasim për kodin për raportimin e të ardhurave dhe shpenzimeve nga kandidatët e subjektit zgjedhor. Ju këtë gjë nuk e keni bërë se ky ka qenë detyrimi i Partisë Demokratike mesa kuptova unë apo është ndryshe e keni bërë?

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Një arsyetim shtesë, në qoftë se bëhet fjalë dhe ne sot nuk jemi këtu për të kontestuar atë që është në ligj por për tu thënë rrethana të posaçme që ka. Në qoftë se bëhet fjalë që unë vendos penalitete të kësaj forme të pretenduar dhe janë pretenduar këto nga KQZ do të thotë që kemi instrumentat e realizimit në qoftë se KQZ kur vendos penalitetet ka edhe detyrimin që merr titull ekzekutiv dhe e realizon edhe me përmbarimin e vet...

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. I. Rusmali: Kjo është çështje tjetër nuk ka lidhje me pyetjen dhe në fakt nuk ka lidhje as me penalitetet. Unë citova nenin dhe fjala penalitet është aty, por qëllimi i nenit është që subjekti zgjedhor disiplinon kandidatët e vet. Përpara kur i cakton ata kandidatë, kur i ka nënmbikqyrje ato nënvëzhgim, nëndrejtim, nënmenaxhim metodologjik etj, subjekti zgjedhor i disiplinon ata i koordinon dhe i disiplinon. Këtë e kërkon ligji që subjekti zgjedhor ta bëjë këtë punë, ju nuk e keni bërë sepse ishte detyrim i Partisë Demokratike apo jo?

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Ju po insistoni në pyetjen tuaj dhe unë jam shumë i ndershëm më shumë se sa duhet dhe po ju them përsëri përsa kohë unë e realizova në katër deputet, të cilët shprehën vullnetin, do të thotë që isha komunikativ me deputetët për ta realizuar edhe me të pestin duke mos arritur të realizoja këtë komunikim se ai refuzohesh. Iu drejtova atij dhe i thashë unë e bëra i thash Partisë Demokratike deri këtu tani këtë të pestin ju lutem shumë merruni ju, pa dyshim. Por ndërkohë konfirmojë kandidatin që po e mora materialin se janë disa formularë ato mora dhe konfirmojë marrjen në dorëzim se ka detyrimin për të deklaruar. Edhe njëherë dua ta sqaroj mbase ju jeni të mjaftuar me atë sqarim që dhashë por prapë po ju them. Thjesht prej financimit të një partie bën postën, merr deklaratimet e financimeve dhe të shpenzimeve të kandidatit dhe e depoziton në KQZ. Kaq është nuk raportoj unë. Unë kam raportuar shpenzimet e partisë time politike se çfarë shpenzimesh ka kryer i kam raportuar kurse për rastin e kandidatëve i'ua shpjegova.

Z. I. Rusmali: Ju referoni shifrën katër ose pesë çfarë do të thotë kjo? Do të thotë që ju si parti politike kishit katër ose pesë kandidatë në zgjedhje?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Atëhere, ka qenë një listë e përbashkët e koalicionit. Në këtë listë të përbashkët janë të klasifikuara si kandidatë të Partisë Republikane dhe ka dalë edhe rezultati përfundimtarë i zgjedhjeve 5 kandidatë edhe vota përkatëse. Nga këto 5 kandidatë pavarësisht se kush ishte burim nga të cilët vinin këta, këto kishin marrë identitetin politike të Partisë Republikane dhe ne mbanim përgjegjësi jo vetëm thjeshtë sepse ishim aleatë por mbanim përgjegjësi se ishim të përgjegjshëm për të realizuar këtë proces. E realizuam në katër kandidatë tek i pesti hasëm vështirësi por jo se ne nuk kemi kryer procedurat se kemi kryer provat përkatëse që kemi komunikuar me financierin e PD iu kemi sjellë...

Z. I. Rusmali: Cilat janë provat?


Z. A. Madhi përfaqësues i PR: Ju kemi sjellë komunikimet elektronike, unë i kam këtu por duhet ti keni në dosje. Janë komunikimet elektronike me kryefinancierin e Partisë Demokratike dhe me kandidatin i cili thotë në rregull. Në qoftë se mundem janë të paraqitura të gjitha komunikimet në datë me orë dhe këtë e keni si prova në dosje.

Z. I. Rusmali: I disponojmë ne këto prova?

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Po.

Z. I. Rusmali: Janë aty.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Ja këtu thotë për shembull Ilir Dervishi drejtohet kjo, ky është financieri i Partisë Demokratike që ne i themi kujdes, ja ka ardhur një raport i KQZ-së për shpenzimet e fushatës nuk do kishit dorëzuar për Ludovik Hasanin janë të gjitha këto komunikimet.

Z. I. Rusmali: Këto komunikime elektronike i përkasin periudhës pas zgjedhjeve.

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Po po pas zgjedhjeve.

Z. I. Rusmali: Janë pas zgjedhjeve.

Z. K. Bele: Më fal, unë këtu pavarësisht se u ezaurua pyetja kisha vetëm një më shumë sqarim se pyetjen e bëri zoti Rusmali. Pra ju qartësisht thoni që subjekti jonë politik ose një subjekt politik për ti dhënë përgjigje gjeneralizuese një subjekt politik në rastin kur provon që kandidati është informuar si në rastin e sqaruar nga ju. Në kushtet e një shkelje të mundëshme të evidentuar penaliteti duhet të jetë jo për subjektin politik po për individin për kandidatin. Kjo është edhe nëse kishit ndonjë reference ligjore për këtë?

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Vendimi numër 13 i Komisionit Rregullator neni 9 pika 3 thotë “financieri përgjigjet për dokumentacionin e dorëzuar për kandidatin te lista shumëemërore dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, me përjashtim të rastit ku nga hetimi administrativ vërtetohet se nuk ka pasur mundësi ose me gjithë përpjekjet e bëra nuk ka arritur të parandalojë ose të korrigjojë shkeljen e kryer nga kandidati. Në këtë rast përgjegjësia për shkeljen i ngarkohet kandidatisit.”

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. K. Bele: Jam i qartë se e ka nenin 90 pika 4.

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Po e ka edhe Kodi Zgjedhor.

Z. K. Bele: Po faleminderit!

Z. I. Rusmali: Ky kandidati i pestë i Republikaneve çfarë identiteti ka, si e ka emrin?

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Ludovik Hasani.

Z. I. Rusmali: Ludovik Hasani për administratën pyetja, është në listën prej 69 kandidatësh që nuk është dorëzuar nga Partia Demokratike apo nuk ka lidhje me atë listë?


Z. Y. Merkaj: Jo nuk është në atë listë.

Z. I. Rusmali: Nuk është në atë listë, faleminderit!

Z. L. Braho: Kam një pyetje për KQZ-në lidhur me afatet e hetimit administrativ. Tani sipas Kodit Zgjedhor dhe vendimit të Rregullatorit hallkat në të cilat duhet të kishte ecur ky proces janë të tilla: Në 13 Korrik 2021 është shpallur rezultati i zgjedhjeve nga Komisioni Rregullator për zgjedhjet e vitit 2021. Sipas kësaj ecurie duhej që deri më 13 Shtator 2021 të ishte bërë depozitimi i raporteve nga partitë politike. Ndërkohë që në datë 18 Shtator duhet të ishte bërë verifikimi i formës nga KQZ edhe me 21 Shtator 2021 të ishte bërë edhe plotësimi. Më tej ngelet afati nga

Zbardhi materialin e inçizuar

Ardita ÇAMI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

21 Tetori 2021 deri më 21 Nëntor 2021 që të bëhet hartimi i raporteve nga audituesit dhe më tej maksimumi një 45 ditësh tjetër që shkon kryhet dhe verifikim nga KQZ që të çon në maksimumi në fund të vitit 2021 dhe në fillim të Janarit 2022. Ndërkohë nga Janar 2022 deri në Dhjetor 2022 që ka dalë ky raporti pse ka zgjatur hetimi administrativ për financimin e zgjedhjeve?

Z. Y. Merkaj: Duke qenë se audituesit kanë pasur pengesa në komunikimin dhe gjetjen e adresave të partive politike është kërkuar gjithmonë shtyrja dhe për këtë arsye është shtyrë edhe mbledhja dhe miratimi i gjetjeve të raportit.

Z. L. Braho: Komunikim me audituesit?

Z. Y. Merkaj: Audituesit kanë bërë kërkesën sepse nuk kanë gjetur adresat e partive dhe financierët dhe raportet financiare të kërkuara.

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Ju lutem edhe një kërkesë. Unë u përpoqa tu them në mënyrën se si komunikova me juve që e vlerësoj shumë këtë hetim të thelluar. Po ky hetimi i thelluar pavarësisht pavarësisht se si do ti analizojë, vlerësoj dhe vendosi për secilin subjekt ka një gjë shumë të madhe. Ne nxorrëm këtu të gjitha problemet që i kemi ne. Nga të cilat njeri që unë vazhdoj të këmbungul është fakti i shkeljes së parimit të panshmërisë, jo më kot ligjvënësi ka thënë “unë nuk kam besim tek KQZ, KQZ mund të vij se është palë dhe ne e dimë si ndërtohet KQZ” dhe ligjvënësi e ka zgjidhur jo do të konfrontohen dy raporti i auditit dhe konstatimet e KQZ-së dhe kur ka parregullësi duhet të ketë një ri auditim të dytë vetëm kështu garantoni paanshmërinë. Kjo metodikë pune, kjo metodologji, kjo procedurë duhet domosdoshmërisht të bëhet detyrim për Komisionin Qendror të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Zgjedhjeve. Që unë të di të gjithë ato gjetje që ka bërë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të njihen. A e dini ju që me ne nuk është lënë të mbahet as një procesverbal për konstatimin e parregullsisë ndërkohë që nuk po i hymë në thelb procedura, kërkon me personin përgjegjës ka emer unë duhet të jem i përgjegjshëm për këtë që kam bërë, të jap edhe reagimin tim.

Z. K. Bele: Këtë gjë e kuptuam dhe nisur edhe nga kjo, në vijim të kësaj qendrim që po mbani zoti Ylli, lidhur me këtë pretendim të ngritur mbi detyrimin ligjor për riauditimin. Është trajtuar kjo dhe çfarë qendrimi ka KQZ për këtë situatë?

Z. Y. Merhaj: Jo, nuk është trajtuar pasi nuk ka lindur nevoja. Nuk ka pasur dhe nuk ka probleme midis raportit dorëzimit të raportit të partive politike dhe raportit të auditimit. Ideja është dhe të gjitha masat dhe sanksionet që ka propozuar Komisioneri është thjesht për mos dorëzimin e raporteve. Në qoftë se ka mos dorëzim raporti nuk ke çfarë të ballafaqohesh sepse nëse e kemi raportin për ta ballafaquar me një gjë të KQZ. Kështu që shumica e masave i është propozuar sepse nuk është dorëzuar raporti.

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Kam një prapësim për këtë unë, unë kam raportin e auditit. Raporti i auditit mbyllet me opinionin e audituesit i cili thotë fondet e akorduara dhe shpenzuara për fushatën zgjedhore për zgjedhjet e datës 25 të Partisë Republikane janë në përputhje me standartet kombëtare të kontabilitetit. Kjo më është dorëzuar në raport mua, pas kësaj kthehet KQZ dhe thotë ke 5 veta.

Z. L. Braho: Të jemi të qartë se po ngatërrojmë konceptet nuk është se Komisioneri ka bërë hetim të thelluar pas asaj. Komisioneri e ka pranuar me çfarë

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

vura re unë. I ka pranuar të gjitha rezultatet e auditit thjeshtë ka konstatuar që një pjesë e partive politike nuk ka depozituar dokumentacionin në mënyrë të plotë. Kjo është!

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Po të keni pasur vëmendje tek një nga kolegët e mi këtu tha një gjë, që ky veprim është bërë pavarësisht se ka qenë raporti i KRIK ai se nuk ka qenë veprimtari e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ka marrë ka lexuar diku dhe atje u zbulua që qenkan disa kandidatë që nuk kanë dorëzuar mbi këtë bazë filloj menjëherë Komisioneri dhe i thamë po skemi një procesverbal, mund të kenë qenë 5 mund të kenë qenë 2 mund të kenë qenë 7. Ju nuk keni bërë një akt që ne të na njoftoni për këtë parregullsi dhe po ju them në emër të transparencës është detyrim që unë të kem për palën përfaqësuese time atje ku unë besoj që siguron pa anshmërinë dhe ligji e ka të siguruar. Kur ke edhe gjëra të tilla që mua më del pa rregullsi ose mbaj aktet ashtu si duhet, personat përgjegjës, më jep kohën të të kthejë përgjigje për relacionet a ku e di unë, kundërshtimet e mija ose kështu nuk veprohet. Unë vij këtu i penalizuar paraprakisht hapet një procedurë administrative në botë nuk e di kush është me kë u mbajt, kush e kontrolloi këtë, kush e gjeti Ludovik Hasanin, në çfarë kushtesh. Po fillova menjëherë të kërkojë për të ezauruar tërësisht këtë temë që mos t'iu lodh juve më shumë. Unë kam një shkresë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mbasi unë i kam çuar letrën, por e dini kur ia kam çuar në 9.12.2022 në procedimin administrativ në hetimin administrativ dhe i them ju lutem më jepni emrin e kandidatit. Unë nuk kisha dijeni për kandidatin dhe më përgjigjet Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe më thotë, në përgjigje të shkresës tuaj dorëzuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ju bëj me dije se zoti Ludovik Hasani është kandidati i cili nuk ka dorëzuar raportin. Pse duhet ti marr kështu nëpërmjet korrespondecave? A nuk duhet të kishte një komunikim një

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

bashkëveprim me ne ku identifikohesh? Mbjaj procesverbalin dhe më jep mua të shoh se çfarë kam bërë, ku i kam bërë. Mund të kishte dijeni, mund të mos kishte dijeni Ludovik Hasani por nuk mund të vihem përpara faktit të kryer nga raporti që vinin në mënyrë të parregullt sa i takon dokumentimit të akteve dhe veprimeve kaq.

Z. L. Braho: Zoti Merkaj kam një pyetje tjetër tani se zotëria ngriti pretendimin, mesa kuptojë unë i bie që ai nuk ka pasur ndonjëherë kontakt me audituesin. Audituesit e bëjnë auditin vetëm në bazë të dokumentacionit që është depozituar në KQZ apo marrin kontakte me përfaqësues të partive politike?

Z. Y. Merkaj: Audituesit marrin kontakte me përfaqësuesit e partive politike, shkojnë tek selia e partisë politike, shikojnë dokumentacionin çfarë ju servir dhe i jep partia politike dhe në bazë të këtij raporti bëjnë gjetjet. Ky raport pastaj në KQZ bëhet verifikimi me raportin që ka sjellë partia politike dhe në fushatë zgjedhore të gjitha partitë politike janë të detyruara që të sjellin përfaqësuesit e tyre në KQZ, duke caktuar emrat e tyre, numrat e telefonit dhe adresën e selive. Mendoj që... kanë detyrim ta sjellin dhe në këto kushte të gjitha partitë janë të njohura dhe njoftohen për mbledhjet për seancat që bëhen të hapura në KQZ. Njoftohen partitë politike, ju çohet akti paraprakë për ta verifikuar, për ta parë, për të dhënë sygjerimet e tyre , numrat e telefonit i kanë thirrje publike janë bërë disa herë për të bërë trajnimin e financierit të partive politike ato parti që kanë pasur interes kanë paraqitur financimet, kanë ardhur kanë bërë trajnimin dhe shumica e partive kanë qenë në rregull ka plotësuar në rregull raportet. Disa parti të tjera që ndoshta e kanë neglizhuar

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. L. Braho: Po këto katër kandidatët e Partisë Republikane kush financier i ka sjellë në KQZ, financieri i Partisë Demokratike apo i Partisë Republikane? Pra nga 5 kandidatë, 4 kandidatë janë sjellë, kush i ka sjellë këto të katërt?

Z. Y. Merkaj: Audituesi duke parë listën shumemërore të Partisë Demokratike janë ndarë 1, 2, 3, 4, 5 janë të Partisë Republikane dhe ky auditues që ka audituar fondet e shpenzuara nga Partia Republikane, ka shkuar tek Partia Republikane dhe ka bërë verifikimin për të gjithë këtë 5 kandidatë dhe për fondet e fushatës së shpenzuara..

Z. I. Rusmali: Ta përsërisë pyetjen në një formë tjetër, kandidatët raportimin e tyre e sjellin në KQZ apo e dërgojnë të partia?

Z. Y. Merkaj: Jo, kandidatët e dërgojnë tek partia dhe partia e sjellë në KQZ. Sipas raportit përfundimtarë me raportin e tyre, ky është vendimi numër 13 i Komisionit Rregullator ...

Z. I. Rusmali: Çfarë nevojë ka Partia Republikane përshëmbull të dijë që se cili kandidat nuk ka dërguar raportin? Raporti dërgohet tek partia.

Z. Y. Merkaj: Tek partia po themi.

Z. I. Rusmali: Po ju keni dhënë përgjigje keni thënë ju themi që filan...

Z. Y. Merkaj: Në përgjigje të shkresës së Partisë Republikane se cili nga kandidtët nuk ka dorëzuar raportin. Ne kemi parë raportin , ne kemi parë raportin e auditimit dhe raportin e partisë dhe kemi thënë që nga këta 4-5 kandidatë...

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. I. Rusmali: Po në raportin e partisë ishte ky kandidatë?

Z.Y. Merkaj: Nuk ishte ky kandidat.

Z. I. Rusmali: Ata që i kishin dorëzuar ishin në raportin e partisë?

Z.Y. Merkaj: Po.

Z. E. Çefa: Me aq sa unë kuptojë më korrigjoni nëse e kam kuptuar mirë ose jo. Ju i keni konsideruar të dorëzuara dhe të administruara nga financieri i Partisë Demokratike këto deklarata për dy nga kandidatët i keni konsideruar të dorëzuara deklaratën që ata kanë dorëzuar tek Partia Demokratike dhe jo tek Partia Republikane apo jo? KQZ këtë pretendim tuajin e ka marrë të mirëqenë gjatë shqyrtimit administrativ dhe ka konstatuar që për një kandidatë nuk është bërë aspak deklarimi apo jo? A e kam kuptuar mirë apo jo?

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Jo, nuk është saktësisht kështu tek vendimi. Unë u'a shpjegova pak më parë, pavarësisht nga taktikat për të cilat nuk ka nevojë ti bëj prezente këtu, ne kishim një listë të përbakësht. Kjo listë e përbashkët kishte 5 kandidatë të identifikuar në listën në fletën e votimit ishin kandidatë të Partisë Republikane. Mund të ishin të 5-të dhe të marrë nga Partia Demokratike kjo nuk ka asnjë rëndësi, në këtë moment kur filloi procesi i depozitimit se është pas zgjedhjeve procesi i depozitimit të akteve atëhere ne në bashkëveprim se kush je ti përgjegjës apo jam unë përgjegjës në lidhje me këtë. Hajde ta bëjmë të gjithë së bashku. Arritëm që në katër ti përmbushim ne, por çfarë përmbushëm ne,

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

përmbushëm kushtin e detyrimit që kandidatët i japin financierit të partisë deklaratat e saj është njëlloj si në ILDKPI japin deklaratat dhe financierja e dorëzon në KQZ. Në rast se qëndron pretendimi

Z. I. Rusmali: Cilët financier, të cilës parti?

Z. A. Madhi përfaqësues i PR: Të Partisë Rep..... jo jo ai nuk e definoi ai thotë i jepet financierit...

Z. I. Rusmali: Si ka ndodhur me këta të katërt se kjo është pyetja. Kujt ia kanë dërguar këta raportimin?

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Këtë rast nuk jam në gjendje t'iu përgjigjem vetëm po ju them që u dorëzuan katër a u dorëzuan nga Partia Demokratike se nuk dua të kapemi me artifica të tilla. Unë po ju them kur erdhi koha e penalizimit atëherë thamë çfarë po bëjmë. Ne hymë në mënyrë të përbashkët bëmë një bashkëveprim por nëse do të shohim strikt ligjin se jemi përpara një gjykate që po na gjykon. Atëherë po them strik ligji pse më ke penalizuar mua. Se sa kam bashkëvepruar unë me Partinë Demokratike se si kam bashkëvepruar kjo është çështja ime. Por kjo nuk më kompromenton mua që do të bëj gjithçka në fund të fundit përgjegjese është subjekti i cili drejton koalicionin. Pra, jemi përpara një gjykimi tani.

Z. L. Braho: Po ne përsëri nuk po e kuptojmë këto katër kandidatë të PR-së kush i ka sjellë në KQZ? I ka sjellë Ilir Dervishi që është financieri Partisë Demokratike apo i ka sjellë financieri i Partisë Republikane? Kush i ka depozituar këtu në KQZ të 4-të kandidatët?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Të paktën informacioni që kam unë se këtu...

Z. L. Braho: Këtë mund të na e sqarojë më mirë KQZ se ju nuk e dini...

Z. Y. Merhaj: Partia Demokratike nuk ka sjellë asnjë kandidatë..

Z. A. Madhi përfaqësues i PR: Jam i bindur që dokumentat e zotit Fatmir Mediu i ka sjellë financiera jonë ka ardhur këtu, nuk ka rëndësi kush financiar i solli. KQZ mori në dorë financimet e zotit Fatmir Mediu..

Z. L. Braho: Është e rëndësishme kjo.

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR: Në rregull unë nuk po paragjykoj se çfarë mendoni juve..

Z. L. Braho: Na i lër të na i shpjegoj pak përfaqësuesi i KQZ, zoti Merjak kush i ka sjellë katër kandidatët e PR-së këtu?

Z. Y. Merhaj: Kandidatët e PR i ka sjellë PR, sepse Partia Demokratike si parti udhëheqëse e koalicionit e cila duhet të sillte 153 kandidatë nuk ka sjellë asnjë as 149 as 5 kandidatë. Nuk është i pavlefshëm mos bashkëpunimi me KQZ i Partisë Demokratike.

Z. E. Çefa: Atëherë zoti Ylli unë lexoj këtu, tani se do të lexoj tekstin që është në propozimin e Komisionerit për KAS-in. 'Partia Republikane ka dorëzuar në KQZ

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

me shkresën numër 3432 datë 26 Tetor 2022 raportet financiare të fushatës zgjedhore për dy kandidatë të listave shumemërore. Zonjën Elda Hoti dhe zonjën Eralda Bano si dhe koorrespondencën me financierin e Partisë Demokratike i cili pra financieri i PD-së konfirmon dorëzimin e raporteve brenda afateve. Rezulton se Partia Republikane nuk ka dorëzuar raportin për një kandidat të listave shumëemërore duke mos respektuar vendimin numër 13”. Pra, unë e kam kuptuar që kandidatët i kanë dorëzuar tek Partia Demokratike deklaratat. Partia Demokratike nuk i ka dorëzuar në KQZ dhe pastaj Partia Republikane për të justifikuar po themi mos veprimin e saj ka marrë një vërtetim nga Partia Demokratike e cila konfirmon që këto kandidatë të PR-së i kanë dorëzuar tek PD deklaratat apo jo? A ka ndodhur kështu ngjarja a e kam kuptuar mirë?

Z. L. Braho: Zoti Ylli në shtesë të kësaj tek raporti i miratuar thotë Partinë Demokratike audituar nga zonja Anida Nuri, e cila ka konstatuar që nga subjekti nuk janë përgatitur deklaruar sipas ligjit pasqyrat e raportimit financiar për fushatën zgjedhore nga rreth 50% e kandidatëve. Tani 50% nuk besoj se i kanë sjellë këto të koalicioneve apo i kanë sjellë partitë e koalicioneve. Partia Demokratike nuk ka sjellë as një emër apo ka sjellë 50%?

Z. Y. Merhaj: Nuk ka sjellë asnjë emër Partia Demokratike. Atëherë është bërë mbledhja e parë për miratimin e gjetjeve. Ka marrë pjesë përfaqësuesi i PR-së i cili ka kërkuar sepse projektvendimi ka qenë për tre kandidatë të PR-së që nuk kanë sjellë raportet. Është kërkuar shtyrje nga përfaqësuesi i PR-së me pretendimin që ne i kemi dorëzuar tek partia udhëheqëse e koalicionit dhe ka shkuar ka marrë komunikimin dhe për këta dy personat, Komisioneri në përfundim të shqyrtimit e ka marrë të mirëqenë këtë e ka pranuar dhe e ka lënë vetëm për një që nuk është

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

justifikuar dhe nuk është gjetur korrespondenca midis financierit të Partisë Demokratike. Këtu ka qenë.

Z. A. Madhi, përfaqësues i PR-së: Unë po ju lexoj komunikimin e plotë zyrtar me Ilir Dervishin. “Përshëndetje jam Suela e PR-së! Përshëndetje si jeni? Doja t’iu pyesja për raportet financiare të kandidatëve - i thotë Suela? Mirë faleminderit! Sot është afati i fundit- i thotë Suela. Unë i kam nisur në total me qarqe jo veçmas thotë Ilir Dervishi. Të shohim tani në qoftë se i kërkojnë veç e veç. Ja dërgojmë pastaj edhe ato që nuk kanë pasur shpenzime - thotë Ilir Dervishi. Në formular duhet vetëm vinin tek financa në qendër jo në KQZ pra i thotë Ilir Dervishi. Lindita Metalia qarku Lezhë, ajo po thotë Ilir Dervishi e kemi çuar, Elda Hoti patjetër edhe këtë e ke thotë, Ludovik Hasani, Eralda Bano Fier, Qani Xhafa Elabsan dhe vazhdon me komunikimin.” Pra kjo ishte një raport i ndërsjellët ndërmjet tyre për të bashkëpunuar për të realizuar qëllimin. Tashmë jemi përpara thashë një gjykatë pavarësisht ka qenë i rregullt nuk ka qenë i rregullt i cili është për më tej se si mund të shpjegohet me udhëzime nuk jam unë përgjegjësi. Unë u përpoqa të ndihmojë të bëj një punë. Dhe këtu një kandidatë që nuk ka bërë as shpenzime jo, dhe ndërkohë unë jam dakord në qoftë se është verifikuar që këtu janë bërë shpenzime 100 lekë nga kandidati nuk janë raportuar nga kandidati jo nga unë, unë kam vetëm raportin financiar mbi shpenzimet që ka kryer Partia Republikane. Atëherë sigurisht kjo është bërë një problem nga ndjekja penale tek këto penalitete që janë administrative. Në këtë kuptim nuk e di pse jam përgjegjës çfarë do të mund të bëjë nesër. Mendoni ju se unë pasi të jem nesër në koalicion unë do ti kthej krahët bashkëpunimit? Jo, përsëri do të bashkëpunoj me aleatin tim. Do të bëj çështë e mundur ti mbyll gjysmën e punës së tij por subjekti përgjegjës përpara shkeljes së një ligji nuk jam unë, nuk e mbaj unë penaltetin nuk jam

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

bashkëpërgjegjës unë. Është ai i cili ligji e njeh si subjektin përgjegjës për të realizuar përmbushur këto detyrime. Ju kërkoj ndjesë për të gjithë këtë zgjatje.

Z. F. Topollaj, përfaqësues PBD: Kam edhe unë një prapësim nuk arrita kur mu bë pyetja dhe mendoj se është e vlefshme. Domethënë mesa duket se nuk kam qenë i qartë në atë që thashë unë. Unë nuk thashë në asnjë moment që kandidatët tanë nuk kanë pasur shpenzime, ajo që unë thashë, është që mënyra se si ne kemi proceduar është që të gjitha shpenzimet edhe ato që ka pasur kandidati ato që ne i konsiderojmë shpenzime që duhen deklaruar ne kemi përdorur një formulë për ti kaluar nëpërmjet partisë. Dhe ju solla rastin e atyre kandidatëve që kanë rezultuar që kanë shpenzuar disa para nga karta e tyre e kreditit gjetja e KRIK në mos gabohem për të sponsorizuar Facebook. Dhe ju thash që kush na ka bërë dhurime janë depozituar në parti dhe çdo shpenzim që kanë bërë kandidatët mund ta kenë bërë aty për aty vetë dhe kanë ardhur dhe shpenzimin e kanë marrë tek partia, këtë ju shpjegova. Dhe e kemi bërë vetë këtë formulë në mënyrë që të mos ngatërroheshim me 153 shpenzimet të më veçme.


Z. I. Rusmali: Si provohet kjo?

Z. K. Bele: Dakord, kjo që thoni ju po si?

Z. F. Topollaj, përfaqësues PBD: Po si provohet, unë kam deklaruar prandaj ju morra shëmbullin e Facebook, unë kam deklaruar për të gjithë partinë shpenzime në reklaminin e Facebook 500 mij të reja, ndërkohë për dy – tre kandidatë raporti më thotë që kam shpenzuar nga karta e tyre shuma shumë të vogla dhe nuk janë raportuar. I kanë gjetur si gjetje të pa raportuara, në fakt ata i kanë shpenzuar ato

Zbardhi materialin e inçizuar

Ardita ÇAMI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

kanë përdorur kartën e tyre por e kanë marrë lekët tek fondi i partisë që ishte për këtë.

Z. I. Rusmali: Ku e keni provën për këtë gjë? Që ata i kanë marrë lekët tek fondi i partisë na servini provat?

Z. F. Topollaj, përfaqësues PBD: Prova është që ne të gjitha shpenzimet e Bindjes Demokratike në Facebook po të hymë në këtë aspektin virtual se si e gjetëm ne se sa lekë kishim shpenzuar se as ne nuk i gjenim dot duke i mbledhur një për një. Futesh virtualisht dhe ta thotë google se sa shpenzime ka bërë kjo parti në fushatë për të gjithë veprimtaritë e veta.

Z. I. Rusmali: Ju po na kërkoni që të futemi ne tek google?

Z. F. Topollaj, përfaqësues PBD: Jo jo të futen ata që kanë bërë auditimin, skeni punë ju.

Z. I. Rusmali: E keni mandat pagesën që të na e sillni ne që ta shohim?

Z. F. Topollaj, përfaqësues PBD: Këto të Facebook për shëmbull nuk janë me mandat pagese.

Z. I. Rusmali: Të lutem mandat pagese është kur ju i jepni kandidatit lekët që ai ka harxhuar për llogarinë tuaj, nga arka juaj i keni dhënë 1 mij lekë sa i keni dhënë por ia keni dhënë me letra këto lekë. Tani kjo është një formë të provuari, formë tjetër të provuari për këtë proces do ishte përshëmbull sikur të na thonit në

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

deklarimet tuaja në raportin tuaj për KQZ-në tek zëri i shpenzimeve facebook ju keni bërë shpjegime për auditin dhe për KQZ-në ku keni thënë që filan kandidatë, filan kandidatë, filan kandidatë kanë bërë proces reklamimi në facebook dhe shpenzimet e tyre janë të përfshira në këtë shifër. E keni këtë sqarim për KQZ-në dhe auditin?

Z. F. Topollaj, përfaqësues PBD: Neve na ka ardhur raporti i KRIK për gjetjet dhe e kemi bërë këtë sqarim tek ky raport.

Z. I. Rusmali: Pra ia keni thënë KRIK-ut këtë sqarim.

Z. F. Topollaj, përfaqësues PBD: Tek raporti i audituesit nuk e di nëse jam i saktë me termin, me institucionin quhet KRIK. Po pra ne na ka sjellë auditimin me shkeljet dhe ne kemi bërë sqarimet për këto shkelje.

Z. I. Rusmali: Çfarë thotë zoti Merkaj nga pozicioni i KQZ-së për të sqaruar provën?

Z. F. Topollaj, përfaqësues PBD: Domethënë që ta mbyll me një fjali dhe unë nuk flas më. Ajo që desha të thosha është që ne të gjitha shpenzimet i kemi kaluar nëpërmjet partisë. Ndërsa nuk kemi konsideruar shpenzim është e vërtet kohën e kandidatëve energjitë që ata kanë shpenzuar gjatë fushatës sepse në kuptimin tonë këto nuk quhen as shpenzime në natyrë as shpenzime financiare. Por të gjitha shpenzimet që sipas ligjit dhe kodit konsiderohen shpenzime në natyrë dhe financiare ne i kemi kaluar nëpërmjet partisë për ta përmbledhur me një raport të vetëm. Kjo ishte ajo që desha të thoja.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KOZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. I. Rusmali: Po zoti Ylli.

Z. Y. Merkaj: Nuk ka qenë objekt i shqyrtimit administrativ kjo pjesa e shpenzimit të instagramit apo të facebook. Partia Bindja Demokratike është marrë propozimi për sanksion vetëm për mosparaqitjen e raporteve të kandidatëve. Po është konstatim por nuk e kemi, nuk është dënuar nuk është penalizuar për këtë pjesë thjesht kemi bërë një sugjerim që ka bërë KRIIK, po nuk e kemi parë pjesë të.

Z. I. Rusmali: Në rregull mënyra se si e lexojmë neve këtë do të thotë që mungon raportimi për 153 kandidatë ndërkohë që është provuar me mjete të tjera që për 10 kandidatë ka pasur shpenzime. Do të thotë në leximin tonë 153 kandidatë nuk u mungon raportimi për shkak se ata nuk kanë pasur shpenzime por u mungon raportimi për shkak se nuk është zbatuar detyrimi ligjor. Ky është pozicioni i Komisionerit.

Z. L. Braho: Unë kam një pyetje zoti Merkaj ky raporti i KRIK është në kohë përpara përfundimit të auditimit? Apo pas përfundimit të auditimit?

Z. Y. Merkaj: Pas përfundimit të hetimit madje është në pjesën e fundit të shqyrtimit administrativ

Z. L. Braho: Pra audituesit nuk e kanë pasur këtë informacionin që sipas KRIK 10 kandidatë kanë bërë sponsorizime por nuk kanë lexuar raportet.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. Y. Merkaj: Atëherë, tek vendimi i Komisionerit ose propozimi ka qenë vetëm gjetjet e raportit të auditimit. Kjo ka qenë e KRIIK nuk e kemi futur fare në hetim administrativ thjesht është konstatuar nga KRIIK. Por ne si KQZ kemi thjesht...

Z. K. Bele: Deri sa gjen vend në këto letrat tona derisa është këtu do të thotë që është bërë pjesë e shqyrtimit administrativ .

Z. Y. Merkaj: Jo, nuk është bërë pjesë

Z. K. Bele: Pastaj mundet që në vendimmarrjen e Komisionerit këto gjetje të mos jenë marrë parasysh. Se ajo po të mos ishte pjesë ne nuk do ta dinim, hetim administrativ për kuptimin e KAS janë ato gjetje të pasqyruara në këto fleta , në këtë kuptim ato gjetje të KRIIK apo të ndonjë organizate çfarë do lloj pale e tretë futet në proces është bërë pjesë e shqyrtimit administrativ në mënyrën e përshkruar nga shqyrtimi administrativ. Ajo që po thua që nuk është bërë pjesë në sanksione këto gjetje.

Z. Y. Merkaj: Po në sanksione.

Z. Y. Merkaj: Po nuk ka qenë shkak i mjaftueshëm për sanksione.

Z. L. Braho: Sipas KQZ ne mos ti marrim parasysh këto çfarë shkruhet për KRIIK, ne mos ti marrim parasysh në vendimmarrje meqenëse edhe Komisioneri nuk i ka marrë parasysh?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. Y. Merkaj: Komisioneri e ka bërë propozimin për marrjen e masës ka qenë sepse të gjitha partitë.... Por meqë po flasim për Partinë Bindja Demokratike ka pasur detyrimin ligjor që 153 kandidatët megjithëse kanë pasur shpenzime zero, të bëjnë raportimin që këta 153 kandidatë kanë shpenzime zero. Këtë nuk kanë bërë dhe vetëm për këtë është marrë propozim për sanksion.

Z. L. Braho: Pra, për Bindjen ne do themi që ka 153 kandidatë me shpenzime zero, ky është propozimi i Komisionerit.

Z. Y. Merkaj: Kishte detyrimin të dorëzonte raportet...

Z. L. Braho: Dakord edhe njëherë, për Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve këto 153 kandidatë është pranuar që e kanë pasur shpenzimin zero, në bazë të auditit?

Z. Y. Merkaj: Jo shpenzimin zero nuk është raportuar fare nuk e dimë sa e ka pasur shpenzimin.

Z. L. Braho: E kuptoj këtë, këtë e kuptoj por tani në raport me këtë që ka shkruar KRIIK ose qendrimi që ka mbajtur KRIIK çfarë qendrimi do mbajmë i është referuar Komisioneri atyre në vendimmarrje apo jo?

Z. Y. Merkaj: Nuk i është referuar dhe nuk ka qenë në shqyrtim administrativ dhe nuk është bërë hetim për këtë. Se po të ishte bërë hetim do ishin thirur këta, do kishim bërë pastaj...

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. L. Braho: Po pse është në raport auditi pastaj, se raporti është bashkëlidhur kërkesës apo vendimmarrjes të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve?

Z. Y. Merkaj: Kanë qenë disa rekomandime po nuk është në shqyrtim, nuk është marrë pjesë e shqyrtimit administrativ.

Z. F. Topollaj, përfaqësues PBD: Një prapësim i fundit nga këto që tha së pari...

Z. K. Bele: E dëgjuam prapësimin e fundit nëse të gjithë do të fillojmë me prapësimet e fundit...

Z. F. Topollaj, përfaqësues PBD: Është dhe e pasaktë në vetvete por besoj se e ndihmon edhe diskutimin. Së pari...

Z. K. Bele: Atëhere, më fal nëse ke një gjë për të shtuar të lutem jo me vlerësime e pa saktë nëse ke një koment për të bërë

Z. F. Topollaj, përfaqësues PBD: Ajo mund të jetë lapsus nuk ka asnjë problem, e pa saktë për shkak të lapsusit jo për shkak...

Z. K. Bele: Mbaj një qendrim të lutem dhe mundohu të jesh konçiz.

Z. F. Topollaj, përfaqësues PBD: Domethënë çfarë ka bërë Bindja Demokratike e para ne i kemi raportuar të gjithë me zero. Sepse nga Sekretari i Përgjithshëm u tha që arsyeja e ndëshkimit është se nuk ka raport për të 153 kandidatët pa i hyrë nëse ata kanë bërë ose jo shpenzime, kjo na u tha së fundmi. E vërteta është që formati i

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita CAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

KQZ-së për raportin e partisë politike në fund ka pasur edhe një fletë me kandidatët me raportimin e kandidatëve dhe fillonte Berat, sipas rendit alfabetik. Këtë fletën e fundit përshembull, Bindja e ka raportuar me zero, raportin e kandidatëve sepse të gjithë kandidatët e secilit qark kanë pasur zero. Siç kemi raportuar me zero dhe ... toptan me zero sepse nuk ka pasur. Ndërsa thelbi i gjësë është që na është gjetur neve që një kandidat që ne e kemi raportuar me zero të këtë bërë shpenzim, ky duhet të jetë thelbi i diskutimit them unë. Sekretari i Përgjithshëm na tha që nuk ka fare kështu gjetjesh për shpenzimet sepse ai raporti i KRIK nuk qenka marrë parasysh.

Z. E. Shabani, përfaqësuesi i Nismës Thurje: Edhe unë doja vetëm të shtoja që mos e merrni parasysh raportin e KRIK për arsye sepse këto prapësime i kemi bërë KQZ-së dhe na është thënë që nuk janë, pra sanksioni i propozuar nuk është bazuar mbi këtë raport i cili po ta shikoni vetë raporti thotë që këta kandidatë kanë harxhuar më pak se 10 dollar, po ne nuk e themi dot po mund të jetë zero po mund të jetë edhe ...

Z. L. Braho: Zoti Merkaj edhe një pyetje të fundit në lidhje me këto deklaratimet, përsëri partitë politike kanë sjellë edhe raportimet secila për partinë, dhe përfaqësuesi i Bindjes pretendon se tek ky raportimi që ka bërë partia është e identifikueshme dhe faktin në qoftë se ka pasur kandidatë që kanë bërë shpenzime në qarqe të caktuara apo jo? Është kjo e verifikueshme?

Z. Y. Merkaj: Jo. Ai duhet të sjelli raport sepse vendimi nr.13...

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita CAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. L. Braho: E kuptojë në mënyrë të tërthortë po them se kuptojë që ka pasur detyrimin për të depozituar kandidatët. Por në mënyrë të tërthortë KQZ apo audituesi mund ta konstatojë këtë nga raporti i partisë politike. Në qoftë se kandidatë specifik në qarqe të caktuara ose nëse qarqe të caktuara pa emra kandidatësh ka pasur shpenzime nga kandidatët. Pra në qarkun Berat ka qenë një kandidat i X partie që ka shpenzuar 100 euro. Mund të dali kjo nga raporti i partisë?


Z. Y. Merkaç: Si rregull duhet të dalë, partia duhet ta dorëzojë raportin në KQZ raportin e shpenzimeve por nuk ka pasur.

Z. L. Braho: Në rregull faleminderit!

Z. K. Bele: Në rregull faleminderit duke qenë se nuk kemi pyetje të tjera në këtë fazë deklarojmë të mbyllur këtë fazë të shqyrtimit. Do ju ftojme nëse, në fakt për ekonomi unë mendoj që nga palët u qartësua qendrimi i tyre, pavarësisht se mund ta sqaronte secili me një fali, por folët më shumë se ... në mënyrë shteruese. Nuk ka folur përfaqësuesi i subjektit FRD.

Z. Y. Merkaç: Atëherë nga buxheti i shtetit marrin lekët partitë politike që janë ... dhe ajo është kthyer nuk ka lidhje me këtë shqyrtim. Ka marrë lekët nuk i ka shpenzuar duhet ti kthejë kaq. Jo nuk është objekt, jemi duke shqyrtuar kërkesën e Komisionerit, nuk jemi tek ankimet.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.01.2023*

Z. K. Bele: Zoti Alfred nuk jemi duke shqyrtuar sot objekti i kësaj seance është propozimi i Komisionerit apo vendimi i Komisionerit të njohur për palët për vendosjen e sanksioneve dhe nuk është kjo, kështu që ...

Z. A. Feto, përfaqësues i FRD: Unë kam qenë përfaqësues i FRD-së në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve por me një ekperiencë shumë të gjatë që nga fillimet e pluralizmit. Do ju kërkoja ndjesë sepse 30 minuta ka që më kanë njoftuar dhe nuk isha i përgatitur të marr...

Z. K. Bele: Do kesh kohën tënde të përgatitesh kur të vij rasti në fjalë. Pra, duke qenë se nga të gjithë pjesmarrësit u kërkuar mos pranimit dhe rrëzimit i kërkesës së Komisionerit për vendosje sanksioni po e konsiderojmë këtë qëndrim të marrë nga secili prej jush si qëndrim përfundimtar dhe në këtë mënyrë po përfundojmë këtë fazë të procedurës. Për shkak të po e quaj të kompleksitetit dhe unicitetit të kësaj çështje më së paku në terma volumore por edhe për interesin që ka si për ne ashtu edhe për ju. Ne do marrim kohën e nevojshme për të vlerësuar pasi është çështje voluminoze sepse çdo subjekt ka specifikat e veta dhe do njoftojmë datën e shpalljes së vendimit nëpërmjet KQZ-së. Pra nuk po caktojmë një datë në këto momente pasi nuk duam që ta ngushtësojmë veten nëpërmjet një date, 2 , 3 apo një javë. Sigurisht në një kohë të arsyeshme dhe do ju njoftojmë për shpalljen e këtij vendimi. Me kaq seancën e deklarojmë të mbyllur. Faleminderit!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita ÇAMI*

